REPUBLIKA E SHQIPËRISË

USHTRIA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

Viti i 82-të i botimit Nr. 41 (827997) | Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes | E premte, 16 tetor 2026



REGJIMENTI I OPERACIONEVE SPECIALE

Elita që bashkon guximin, profesionalizmin dhe besnikërinë ndaj atdheut

» faqe 8



MINISTRI NUFI NË QAPU BUNAVI: UNIFORMA USHTARAKE ËSHTË PRIVILEGJI, KRENARIA DHE NDERI JUAJ!

Ministri i Mbrojtjes, Ermal Nufi, dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant Arben Kingji, vizituan Qendrën e Arsimimit Profesional të Ushtarit në Bunavi, Vlorë, ku u njohën nga afër me procesin e formimit dhe përgatitjes së brezave të rinj të ushtarakëve. Qendra e Arsimimit Profesional të Ushtarit (QAPU), në Bunavi të Vlorës, vijon të jetë një nga strukturat...

faqe 3



GJENERALLEJTËNANT ARBEN KINGJI NË CEREMONINË E MARRJES SË DETYRËS SË KOMANDANTIT TË RI TË KFOR-IT

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant Arben Kingji, mori pjesë në ceremoninë e marrjes së detyrës nga komandanti i ri i KFOR-it, gjeneralmajor Roberto Vergori. Përmes një mesazhi me këtë rast, gjenerallejtënant Kingji theksoi rëndësinë e vijimit të kontributit të Forcave të Armatosura Shqiptare në kuadër të Aleancës, veçanërisht në misionin...

faqe 2



NGA DIPLOMACIA TE PODIUMET NDËRKOMBËTARE, NGA SPORTI ELITAR TE TRASHËGIMIA KOMBËTARE, RRUGËTIMI I MARIN MEKSIT

Intervistoi: ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Me rreth dy dekada përvojë në Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë, Marin Meksi ka shërbyer në misione diplomatike jashtë vendit, ndër të cilat në Budapest të Hungarisë dhe në Bernë të Zvicrës, me mbulim diplomatik edhe për Principatën...

faqe 5

Gjenerallejtënant Arben Kingji në ceremoninë e marrjes së detyrës së komandantit të ri të KFOR-it

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant Arben Kingji, mori pjesë në ceremoninë e marrjes së detyrës nga komandanti i ri i KFOR-it, gjeneralmajor Roberto Vergori.

Përmes një mesazhi me këtë rast, gjenerallejtënant Kingji theksoi rëndësinë e vijimit të kontributit të Forcave të Armatosura Shqiptare në kuadër të Aleancës, veçanërisht në misionin e KFOR-it, i cili luan një rol të rëndësishëm në garantimin e paqes dhe sigurisë në Kosovë dhe në rajon.

"Është kënaqësi të marr pjesë në ceremoninë e marrjes së detyrës së komandantit të ri të KFOR-it, gjeneralmajor Roberto Vergori. Forcat e Armatosura do të vijojnë kontributin ndaj Aleancës, veçanërisht në këtë mision të rëndësishëm, në përmbushjen e synimeve të përbashkëta për paqe dhe siguri në Kosovë dhe në rajon", - u shpreh gjenerallejtënant Arben Kingji.

Pjesëmarrja e Shqipërisë në misionin e KFOR-it dëshmon angazhimin e vazhdueshëm të Forcave të Armatosura Shqiptare në mbështetje të sigurisë kolektive, bashkëpunimit me aleatët dhe ruajtjes së një mjedisi të qëndrueshëm e të sigurt në rajon.





Batalioni i Xhenios në shërbim të komunitetit, ndërtohet ura metalike "Bailey" në Izvor

Ndërhyrja e Forcave të Armatosura përmirëson aksesin e banorëve drejt shërbimeve bazë dhe lehtëson lëvizjen në zonën e Luftinjës, Bashkia Memaliaj

Batalioni i Xhenios ka përfunduar me sukses operacionin special xhenier për ndërtimin e një ure metalike të tipit "Bailey" në fshatin Izvor, Njësia Administrative Luftinjë, Bashkia Memaliaj.

Ura e re, me gjatësi 12 metra dhe seksion 1/1, përbën një ndërhyrje të rëndësishme për përmirësimin e infrastrukturës lokale dhe lehtësimin e lëvizjes së banorëve të zonës. Ndërtimi i saj do të mundësojë akses më të lehtë drejt shërbimeve bazë, duke ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e kushteve të jetesës dhe të komunikimit të komunitetit.



Realizimi i këtij operacioni dëshmon kapacitetet profesionale dhe gatishmërinë operacionale të Batalionit të Xhenios për të ndërhyrë në funksion të nevojave të komunitetit, veçanërisht në zonat ku infrastruktura kërkon ndërhyrje për të garantuar lidhjen dhe lëvizjen e sigurt të banorëve. Përtej detyrave të mirëfillta ushtarake, Forcat e Armatosura vijojnë të kontribuojnë edhe në mbështetje të autoriteteve civile dhe komuniteteve lokale, përmes angazhimit të personelit të specializuar dhe kapaciteteve xheniere.

Batalioni i Xhenios mbetet një strukturë e rëndësishme në përmbushjen e këtyre detyrave, duke vënë në shërbim të qytetarëve ekspertizën, profesionalizmin dhe kapacitetet e tij teknike. Ndërtimi i urës në Izvor është një tjetër dëshmi e këtij angazhimi, në funksion të përmirësimit të infrastrukturës, rritjes së sigurisë dhe mirëqenies së komunitetit.



Batalioni i Xhenios, në vijën e parë për garantimin e sigurisë së komunitetit

Specialistët e Kompanisë EOD vijojnë operacionet për evidentimin, largimin dhe asgjësimin e municioneve të rrezikshme në bashkitë Tiranë dhe Gjirokastër

Batalioni i Xhenios i Forcave të Armatosura vijon angazhimin e tij në shërbim të sigurisë së qytetarëve, përmes operacioneve të specializuara për evidentimin, largimin dhe asgjësimin e municioneve të rrezikshme në territorin e vendit.

Efektivët e Kompanisë EOD po zhvillojnë operacione në bashkitë Tiranë dhe Gjirokastër, me synim identifikimin dhe trajtimin e municioneve të rrezikshme, të cilat mund të përbëjnë kërcënim për jetën e qytetarëve dhe sigurinë e mjedisit.



Këto ndërhyrje kërkojnë profesionalizëm të lartë, përgatitje të specializuar, disiplinë dhe zbatim rigoroz të procedurave teknike e standardeve të sigurisë. Specialistët EOD kryejnë detyrat e tyre me përgjegjësi të veçantë, duke vlerësuar rreziqet dhe duke ndërmarrë masat e nevojshme për trajtimin e sigurt të municioneve të rrezikshme.



Operacionet e pastrimit të territorit nga municionet e paplasura dhe mjetet shpërthyese përbëjnë një kontribut të drejtpërdrejtë në mbrojtjen e jetës së njerëzve, parandalimin e aksidenteve dhe krijimin e një mjedisi më të sigurt për komunitetet lokale.

Përmes angazhimit të vazhdueshëm të specialistëve të tij, Batalioni i Xhenios dëshmon rëndësinë e kapaciteteve të specializuara të Forcave të Armatosura në mbështetje të sigurisë publike. Çdo ndërhyrje e përfunduar me sukses përfaqëson një hap më shumë drejt reduktimit të rreziqeve dhe mbrojtjes së qytetarëve.

Forcat e Armatosura vijojnë të mbeten në shërbim të vendit dhe të komunitetit, duke vënë në dispozicion të tij profesionalizmin, përgatitjen dhe gatishmërinë e efektivëve për përmbushjen e misionit në çdo kohë dhe në çdo rrethanë.

STAFI

ANJEZA MUSOLLARI
Shefe e Sektorit të Botimeve & Kryeredaktor

Redaktore/ korrektore:
Suela **HODA**

Graphic Designer:
Afërdita **HYSAJ**

ADRESA:
Rruga e Dibrës/ Garnizoni "Skënderbej"

Ministri Nufi në QAPU Bunavi: Uniforma ushtarake është privilegji, krenaria dhe nderi juaj!

Ministri i Mbrojtjes, Ermal Nufi, dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant Arben Kingji, vizituan Qendrën e Arsimimit Profesional të Ushtarit në Bunavi, Vlorë, ku u njohën nga afër me procesin e formimit dhe përgatitjes së brezave të rinj të ushtarakëve.

Qendra e Arsimimit Profesional të Ushtarit (QAPU), në Bunavi të Vlorës, vijon të jetë një nga strukturat e rëndësishme të formimit ushtarak, aty ku të rinjtë që zgjedhin uniformën hedhin hapat e parë drejt një profesioni që kërkon disiplinë, përgjegjësi, qëndrueshmëri dhe përkushtim ndaj Atdheut.

Ministri i Mbrojtjes, Ermal Nufi, i shoqëruar nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant Arben Kingji, zhvilloi një vizitë në këtë qendër, ku u takua me studentët, kadetët dhe ushtarët e rinj që po ndjekin programet e trajnimit ushtarak, si dhe me drejtuesit dhe instruktorët përgjegjës për përgatitjen e tyre.

Gjatë vizitës, ministri Nufi vlerësoi rolin e QAPU-së në formimin profesional dhe edukimin ushtarak të brezave të rinj, duke theksuar se përgatitja e një ushtaraku nuk kufizohet vetëm te përvetësimi i njohurive teorike dhe aftësive praktike. Ajo përfshin edhe ndërtimin e karakterit, kultivimin e disiplinës, forcimin e përgjegjësisë individuale dhe zhvillimin e frymës së bashkëpunimit, vlera që përbëjnë themelin e një force të bashkuar dhe të aftë për të përmbushur misionin e saj.

“Uniforma ushtarake është privilegji juaj i jetës, është krenaria juaj, është edhe nderi juaj!”, - u shpreh ministri Nufi, duke iu drejtuar të rinjve që kanë zgjedhur t’i përkushtohen shërbimit ushtarak.

Mesazhi i tij përcolli rëndësinë që mbart zgjedhja për t’i shërbyer vendit me uniformë. Përtej një profesioni, shërbimi ushtarak përfaqëson një angazhim ndaj interesave kombëtare, respektimit të detyrës dhe gatishmërisë për të përballuar sfida në shërbim të qytetarëve dhe sigurisë së vendit.

Formimi ushtarak, përtej aftësive profesionale

Duke u ndalur te procesi i trajnimit, ministri Nufi theksoi se periudha e formimit ushtarak është një etapë vendimtare në përgatitjen e çdo ushtaraku, pasi pikërisht gjatë saj ndërtohen bazat e disiplinës, qëndrueshmërisë fizike e psikologjike dhe aftësisë për të vepruar si pjesë e një ekipi.

“Gjatë tre muajve të trajnimit, mësohet disiplina, rregullat, qëndrueshmëria, bashkëpunimi dhe, mbi të gjitha, kuptimi i të qenit pjesë e një force që funksionon si një e tërë. Këtu, suksesi nuk matet vetëm me aftësinë për të përmbushur një detyrë apo për të zotëruar një aftësi ushtarake. Ai matet edhe me karakterin, me respektin për shokun, me besimin te skuadra dhe me gatishmërinë për të mos e lënë kurrë pas atë që ka nevojë për ndihmë”, - theksoi ministri Nufi.

Ky parim përbën një nga shtyllat e edukimit ushtarak, ku suksesi individual merr kuptim të plotë vetëm në funksion të suksesit të grupit. Disiplina, solidariteti dhe besimi i ndërsjellë janë elemente thelbësore për ndërtimin e një force që vepron e koordinuar, përballon vështirësitë dhe përmbush detyrat me profesionalizëm.

Në këtë proces, një rol të rëndësishëm kanë drejtuesit dhe instruktorët e Qendrës, të cilët përcjellin jo vetëm njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për shërbimin ushtarak, por edhe vlerat e etikës, përgjegjësisë dhe respektit për uniformën. Ministri vlerësoi rëndësinë e përgatitjes së vazhdueshme dhe të ruajtjes së standardeve të larta në formimin e personelit të Forcave të Armatosura.

Investimi te njerëzit, themel i modernizimit të Forcave të Armatosura

Duke iu referuar zhvillimeve të sigurisë dhe kërkesave të reja ndaj strukturave ushtarake, ministri Nufi nënvizoi se Shqipëria ka nevojë për personel profesionist, të aftë të përshtatet me ndryshimet dhe të veprojë në përputhje me standardet e NATO-s.



“Ky është drejtimi që duhet të ndjekim: një Forcë e Armatosur që mëson vazhdimisht, përshtatet me ndryshimet dhe investon te njerëzit e saj po aq sa investon në modernizimin e kapaciteteve. Në një mjedis sigurie që ndryshon me shpejtësi, Shqipëria ka nevojë për ushtarakë profesionistë, të aftë dhe të përgatitur për të vepruar sipas standardeve të NATO-s, për të përballuar sfidat e reja dhe për të kontribuar me përgjegjësi në sigurinë tonë të përbashkët euroatlantike”, - theksoi ministri i Mbrojtjes.

Ky vizion e vendos burimin njerëzor në qendër të procesit të modernizimit të Forcave të Armatosura. Pajisjet bashkëkohore dhe kapacitetet e reja ushtarake kërkojnë personel të mirë trajnuar, të aftë për t’i përdorur ato me profesionalizëm dhe për të përmbushur detyrat në një mjedis operacional gjithnjë e më kompleks. Për këtë arsye, cilësia e arsimimit dhe e stërvitjes mbetet një faktor përcaktues për rritjen e gatishmërisë dhe ndërveprueshmërisë me aleatët.

QAPU, porta e formimit të brezave të rinj ushtarakë

Angazhimi në arsimimin dhe formimin ushtarak vijon të shoqërohet me programe trajnimi për kategori të ndryshme të personelit. Javën e kaluar, në Qendrën e Arsimimit Profesional të Ushtarit nisën fazën e formimit ushtarak 78 studentë të Kursit të Përgatitjes së Oficerit, të cilët do të ndjekin një trajnim dhjetë javor, si dhe 80 studentë të ciklit bachelor, për një trajnim pesë javor.

Këto programe synojnë të përgatisin studentët për përgjegjësitë e ardhshme në strukturat ushtarake, duke u dhënë njohuritë bazë dhe duke i njohur me kërkesat, normat dhe standardet e jetës ushtarake.





Qendra e Arsimimit Profesional të Ushtarit në Bunavi luan një rol thelbësor në formimin bazë dhe të avancuar të personelit, duke shërbyer si një urë lidhëse ndërmjet jetës civile dhe asaj ushtarake. Aty ndërtohen themelet e profesionit të ushtarakut dhe kultivohet përgjegjësia për të përmbushur detyrat me ndershmëri, përkushtim dhe profesionalizëm.

Vizita e ministrit të Mbrojtjes, Ermal Nufi, dhe e shefit të Shtabit të Përgjithshëm, gjenerallejtënant Arben Kingji, rikonfirmon rëndësinë e investimit te njerëzit dhe e përgatitjes së brezave të rinj si një prioritet për zhvillimin e Forcave të Armatosura.

Sepse pas çdo kapaciteti ushtarak qëndrojnë njerëzit që e vënë atë në funksion; pas çdo misioni të përmbushur qëndrojnë përgatitja, disiplina dhe besimi; ndërsa pas çdo uniforme qëndron një zgjedhje që kërkon përgjegjësi dhe nder. Në Bunavi, ky formim merr jetë çdo ditë, duke përgatitur ushtarakët e rinj për t’i shërbyer Shqipërisë dhe për të kontribuar në sigurinë e përbashkët euroatlantike.

Forca Tokësore shqiptare dhe ajo italiane zhvillojnë bisedimet bilaterale "ALB-ITA Army Staff Talks"

Në Komandën e Forcës Tokësore, në Zall-Herr, u zhvilluan bisedimet bilaterale "ALB-ITA Army Staff Talks", ndërmjet Forcës Tokësore të Republikës së Shqipërisë dhe Forcës Tokësore të Republikës së Italisë, me fokus forcimin e bashkëpunimit ushtarak dhe planifikimin e aktiviteteve të përbashkëta për periudhën në vijim.

Gjatë takimit, palët diskutuan mbi realizimin e aktiviteteve të planifikuara për vitin 2026, si dhe përcaktimin e prioriteteve të bashkëpunimit për vitin 2027. Një vëmendje e veçantë iu kushtua thellimit të partneritetit ndërmjet Grup-Batalionit të Këmbësorisë së Lehtë të Forcës Tokësore shqiptare dhe Brigadës italiane "Pinerolo", me synim rritjen e ndërveprueshmërisë dhe forcimin e kapaciteteve operacionale.

Bisedimet shërbyen gjithashtu për të shqyrtuar mundësi të reja bashkëpunimi afatgjatë, në funksion të shkëmbimit të përvojave, zhvillimit të stërvitjeve të përbashkëta dhe rritjes së gatishmërisë operacionale të të dyja forcave.

Bashkëpunimi ndërmjet Forcës Tokësore shqiptare dhe asaj italiane përbën një kontribut të rëndësishëm në forcimin e marrëdhënieve dypalëshe në fushën e mbrojtjes, duke mbështetur objektivat e përbashkëta për sigurinë dhe stabilitetin rajonal, si dhe angazhimet në kuadër të Aleancës së Atlantikut të Veriut (NATO).







Komandanti i Forcës Tokësore merr pjesë në AUSA 2026, në Washington D.C.

Komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralmajor Petrit Çuni, i shoqëruar nga drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Modernizimit të Kapaciteteve dhe Armatimit në Ministrinë e Mbrojtjes, gjeneral brigade Ardian Lilo, mori pjesë në aktivitetin *"AUSA Annual Meeting & Exposition 2026"*, që zhvillohet në Washington D.C., SHBA.

Ky aktivitet përbën një nga forumet më të rëndësishme të Forcës Tokësore të SHBA-së dhe një platformë strategjike për bashkëbisedimin mes drejtuesve ushtarakë, përfaqësuesve të vendeve aleate dhe partnere, si dhe industrisë së mbrojtjes. Me mbi 40 000 pjesëmarrës, më shumë se 750 ekspozues dhe përfaqësues nga mbi 100 vende, AUSA 2026 krijon mundësi të rëndësishme për shkëmbimin e përvojave, prezantimin e teknologjive të reja dhe diskutimin mbi sfidat e së ardhmes në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

Pjesëmarrja e përfaqësuesve të Forcës Tokësore dhe Ministrisë së Mbrojtjes në këtë forum dëshmon angazhimin e Shqipërisë për forcimin e bashkëpunimit me Ushtrinë Amerikane dhe aleatët e NATO-s, rritjen e ndërveprueshmërisë, si dhe avancimin e prioriteteve të modernizimit dhe inovacionit në kapacitetet ushtarake.

Një vëmendje e veçantë i kushtohet gjithashtu thellimit të partneritetit strategjik Shqipëri–SHBA, si një shtyllë e rëndësishme e bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kolektive.

Pjesëmarrja në *"AUSA Annual Meeting & Exposition 2026"* përfaqëson një mundësi për të ndjekur nga afër zhvillimet më të fundit në teknologjinë ushtarake, për të identifikuar praktikat bashkëkohore dhe për të kontribuar në përpjekjet për ndërtimin e një Force Tokësore moderne, të ndërveprueshme dhe të aftë për të përmbushur detyrimet kombëtare dhe ato në kuadër të NATO-s.







Forcat Detare shqiptare në Simpoziumin XV Trans-Rajonal të Fuqive Detare në Venecia

Kundëradmiral Arsen Mullaj merr pjesë në forumin ndërkombëtar për sigurinë detare, bashkëpunimin dhe të ardhmen e fuqisë detare

Edicioni XV i Simpoziumit Trans-Rajonal të Fuqive Detare (Trans-Regional Seapower Symposium), i zhvilluar për dy ditë në Venecia të Italisë, përfundoi me sukses, duke mbledhur drejtues të forcave detare, përfaqësues të vendeve anëtare të NATO-s dhe vendeve partnere, si dhe ekspertë të politikëbërjes, industrisë dhe akademisë.

Në këtë aktivitet të rëndësishëm ndërkombëtar mori pjesë edhe Komandanti i Forcave Detare të Republikës së Shqipërisë, kundëradmiral Arsen Mullaj, duke përfaqësuar Forcat e Armatosura Shqiptare në diskutimet mbi sfidat aktuale dhe perspektivat e zhvillimit të sigurisë detare.

Simpoziumi shërbeu si një forum i rëndësishëm për trajtimin e çështjeve që lidhen me mjedisin e ndryshueshëm gjeopolitik, mbrojtjen e hapësirave detare, forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe përshtatjen e kapaciteteve detare ndaj sfidave të reja të sigurisë. Në fokus të diskutimeve ishin gjithashtu inovacioni teknologjik, zhvillimi i fuqisë detare dhe nevoja për koordinim më të ngushtë ndërmjet aleatëve dhe partnerëve.



Përballë një mjedisi strategjik gjithnjë e më kompleks, bashkëpunimi ndërmjet forcave detare konsiderohet thelbësor për rritjen e ndërveprueshmërisë, shkëmbimin e informacionit dhe përvojave, si dhe për përmirësimin e aftësive për t'iu përgjigjur kërcënimeve dhe sfidave që prekin sigurinë e hapësirave detare.

Një aspekt i rëndësishëm i simpoziumit ishte edhe mundësia për zhvillimin e takimeve dypalëshe dhe shumëpalëshe mes përfaqësuesve të forcave detare. Këto takime krijojnë hapësira për thellimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit, identifikimin e fushave me interes të përbashkët dhe nxitjen e iniciativave që kontribuojnë në forcimin e sigurisë detare në nivel rajonal dhe ndërkombëtar.

Pjesëmarrja e Komandantit të Forcave Detare, kundëradmiral Arsen Mullaj, në këtë forum dëshmon angazhimin e Shqipërisë për të qenë pjesë aktive e dialogut ndërkombëtar mbi sigurinë detare dhe për të forcuar bashkëpunimin me vendet aleate e partnere. Për Shqipërinë, si vend me dalje në detin Adriatik dhe Jon, siguria detare përbën një element të rëndësishëm të sigurisë kombëtare dhe të angazhimeve në kuadër të NATO-s.

Simpoziumi Trans-Rajonal i Fuqive Detare mbetet një platformë me rëndësi për bashkërendimin e qëndrimeve, shkëmbimin e ekspertizës dhe diskutimin e perspektivave të zhvillimit të forcave detare, në funksion të përballimit të sfidave të përbashkëta dhe ruajtjes së një mjedisi detar të sigurt e të qëndrueshëm.

Nga diplomacia te podiumet ndërkombëtare, nga sporti elitar te trashëgimia kombëtare

RRUGËTIMI I MARIN MEKSIT

Një rrugëtim mes diplomacisë, sportit elitar, shërbimit publik dhe trashëgimisë historike shqiptare



Intervistoi: ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Me rreth dy dekada përvojë në Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë, Marin Meksi ka shërbyer në misione diplomatike jashtë vendit, ndër të cilat në Budapest të Hungarisë dhe në Bernë të Zvicrës, me mbulim diplomatik edhe për Principatën e Lihtenshtajnit. Formimi i tij akademik përfshin drejtësinë, të drejtën ndërkombëtare, administrimin publik, politikat dhe studimet diplomatike, ndërsa interesat profesionale shtrihen edhe në fushat e migracionit, luftës kundër trafiqeve të paligjshme, diplomacisë ekonomike dhe promovimit kulturor. Paralelisht me veprimtarinë institucionale, ai është angazhuar në mësimdhënie pranë institucioneve të formimit profesional, duke ndarë njohuritë dhe përvojën e tij me brezat e rinj.

Një tjetër dimension i rëndësishëm i profilit të Marin Meksit është sporti. Për më shumë se 25 vjet, ai i është përkushtuar bodybuildingut, fitnessit dhe sporteve të forcës, duke arritur rezultate në gara kombëtare dhe ndërkombëtare. Sipas të dhënave të paraqitura për karrierën e tij, ndër arritjet më të rëndësishme është suksesi në **kompeticionin botëror Diamond Cup Lesufonia&Elite Pro World Championship, në Portugali, në kategorinë Men's Classic Bodybuilding deri në 180 centimetra, si dhe vendi i katërt në kategorinë absolute.** Ky rezultat u shoqërua me kualifikimin e tij si bodybuilder profesionist, duke shënuar një moment të rëndësishëm në karrierën sportive.

Përtej garave dhe rezultateve individuale, Meksi është angazhuar në zhvillimin dhe promovimin e sporteve të forcës në Shqipëri. Nëpërmjet bashkëpunimit me organizatorë dhe institucione sportive, ai ka kontribuar në sjelljen dhe organizimin e kompeticioneve ndërkombëtare në bodybuilding dhe fitness, powerlifting dhe mundje krahu, duke synuar krijimin e më shumë mundësive për sportistët shqiptarë dhe rritjen e përfaqësimit të vendit në këto disiplina.

Kontributi i tij në sport dhe në jetën shoqërore është shoqëruar me vlerësime të shumta. Ndër to spikat titulli **"Mjeshtër i Madh"**, i akorduar nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, si dhe grada honorifike **"Kolonel"**, e dhënë në shenjë vlerësimi për arritjet e tij si sportist elitar. Këto vlerësime përfaqësojnë një dimension të veçantë të karrierës së tij dhe duhen parë në kontekstin e kontributit sportiv e shoqëror, pa i ngatërruar me një karrierë të zakonshme ushtarake. Po kështu, titulli **"Qytetar Nderi i Gjirokastrës"**, i akorduar nga Këshilli Bashkiak i qytetit, shënon një vlerësim të veçantë për promovimin e sportit, të jetesës së shëndetshme dhe të angazhimit në komunitet, veçanërisht në raport me rininë.

Lidhja me Gjirokastrën ka për të edhe një domethënie personale e historike. **Marin Meksi është i angazhuar në studimin e historisë dhe heraldikës shqiptare,** me interes të veçantë për familjen Meksi dhe gjurmët e saj në historinë kombëtare. Hulumtimet e tij përqendrohen te kontributet që u atribuohen brezave të kësaj familjeje në jetën politike, diplomatike, juridike, arsimore dhe kulturore shqiptare. Në këtë kontekst përmendet edhe Vangjel Meksi, i njohur për veprimtarinë e tij në përkthimin e Dhiatës së Re dhe për kontributin në historinë e gjuhës shqipe. Studimi i kësaj trashëgimie përbën një përpjekje për të njohur më mirë rolin e individëve dhe familjeve në zhvillimin e institucioneve, kulturës dhe identitetit kombëtar.

Përvoja e Meksit shtrihet edhe në publicistikë dhe botime shkencore, ku ka kontribuar si autor dhe bashkautor në fusha që lidhen me diplomacinë, financën dhe kulturën. Ndërthurja e këtyre interesave me karrierën diplomatike dhe sportive e paraqet atë si një personazh me disa dimensione, ku përgatitja profesionale bashkëjeton me kërkimin historik dhe përkushtimin ndaj sportit.

Në këtë intervistë, biseda me Marin Meksin synon të shkojë përtej titujve, medaljeve dhe arritjeve të renditura në një biografi. Ajo kërkon të zbulojë rrugëtimin personal, sfidat, bindjet dhe përvojat që kanë ndikuar në formimin e tij; këndvështrimin mbi diplomacinë dhe përfaqësimin e Shqipërisë; rëndësinë e sportit në edukimin e karakterit; si dhe përgjegjësinë për ta ruajtur e përcjellë trashëgiminë historike te brezat e rinj.

Një bashkëbisedim mbi ambicien dhe vetë-disiplinën, mbi identitetin dhe përkatësinë, por edhe mbi një pyetje që mbetet thelbësore për çdo njeri që synon të lërë gjurmë: si mund të shndërrohen arritjet personale në vlera që i shërbejnë shoqërisë dhe vendit?



Formimi akademik dhe rrugëtimi profesional

Zoti Meksi, jeta juaj profesionale përfshin diplomacinë, drejtësinë, sigurinë, studimin e historisë dhe sportin elitar. Si do ta përkufizonit veten dhe cila është ideja që i bashkon këto fusha në rrugëtimin tuaj?

Figura e një diplomati është shumë komplekse dhe multidimensionale, ndaj ky gërshetim duket se e ka plotësuar figurën time si shërbestar publik, duke vendosur pikërisht në thelb historinë dhe traditën tonë të lashtë e fisnike, drejtësinë si shtyllën më të rëndësishme të një shteti, sigurinë si garantues të paqes dhe sportin, i cili quhet ndryshe dhe kulturizëm, pasi ka në brendësi performancën artistike, ku ne shqiptarët nëpërmjet sportit dhe artit kemi promovuar gjithnjë vlerat më të mira të vendit tonë në arenën ndërkombëtare.

Formimi juaj akademik nisi në Fakultetin e Drejtësisë në Tiranë dhe vijoi me studime pasuniversitare në të drejtën ndërkombëtare, administrimin publik, politikat dhe diplomacinë. Sa kanë ndikuar këto studime në mënyrën se si e kuptoni shtetin, institucionet dhe marrëdhëniet ndërkombëtare?

Jurisprudencën e kam një formë amaneti nga paraardhës tanë të fisit Meksi, të cilët kanë qenë themelues të shtetit të së drejtës dhe i ngjizur në një ambient me një literaturë të madhe akademike, nuk kishte si të ndodhte ndryshe. Shtetin e kam kuptuar gjithnjë si formën më të lartësuar të tempullit të shërbimeve ndaj qytetarëve dhe mbrojtësin më të madh të të drejtave të tyre Brenda dhe jashtë vendit, një ekuilibër organigrame me një balancë pushtetesh të pavarur me sistemin plotësues check&balance.

Studimet në Akademinë Diplomatike "Clingendael" në Hagë, si dhe formimi në fushën e diplomacisë dhe sigurisë në Meksikë e në institucione të tjera ndërkombëtare, ju kanë ofruar një këndvështrim të gjerë profesional. Cilat përvoja kanë ndikuar më shumë në formimin tuaj dhe çfarë ju kanë mësuar për rolin e Shqipërisë në një botë gjithnjë e më të ndërlidhur?

Sigurisht Akademia Diplomatike më e madhe në botë, "Clingendael" në Hagë, është tempulli nga kanë dalë mendjet më të ndritura të artit të diplomacisë dhe Akademia e Meksikës, mjeshtrit e mëdhenj të penës ameriko-latinase. E të lundrosh në këto ujëra është një eksperiencë e jashtëzakonshme profesionale. Si një vend postkomunist dhe me një tranzicion të brishtë, zhvillimet politike të vendit tonë janë vlerësuar për progresin e bërë dhe për këtë vendit tonë i është besuar anëtarësia në Aleancën e Atlantikut, liberalizimi i vizave, mandati dyvjeçar në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, Kryesimi i OSBE-së, Kryesimi i Komitetit të Ministrave të KIE-së, anëtarësimi në KDNJ, organizimi i Samiteve të rëndësishëm si ai i Procesit të Berlinit apo BE-Western Balkan etj., për të arritur tek qershia mbi tortë, integrimi i Shqipërisë në Familjen e madhe Evropiane. Të gjitha këto arritje janë falë punës së jashtëzakonshme të institucioneve tona të cilat shihen me shumë respekt në politikën ndërkombëtare. Roli i Shqipërisë për vetë pozitën gjeografike dhe rolin në Gjeopolitikë është mjaft i rëndësishëm si për stabilitetin në rajon por dhe për vetë Evropën e Bashkuar dhe partnerët tanë strategjikë e SHBA në veçanti.

Ju keni vijuar edhe studimet e doktoratës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Çfarë synoni të arrini përmes kërkimit shkencor dhe si mund të shërbejë dija e avancuar për përmirësimin e politikave publike dhe forcimin e institucioneve shqiptare?

Duke qenë një faktor kyç në Ballkanin Perëndimor dhe Evropën Juglindore, vendi ynë çdo projeksion duhet ta bëjë tashmë në një grup më të madh, duke bashkërenduar politikat strategjike me ato të fqinjëve tanë dhe së bashku me ato të Bashkimit Evropian, ndaj dhe politikat tona publike dhe kapacitetet institucionale duhet të përgatiten për një kapacitet më të gjerë dhe sfida të reja. Pra linjëzimi dhe koordinimi i bashkëpunimit institucional i zbatuar në projekte të përbashkëta bëjnë të mundur konsolidimin e veprimeve të përbashkëta largpamëse.

Diplomacia dhe përfaqësimi i Shqipërisë

Prej rreth 20 vitesh jeni pjesë e Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Shqipërisë. Çfarë përfaqëson për ju diplomacia: një profesion, një mision shtetëror apo një përgjegjësi për të përfaqësuar me dinjitet interesat dhe identitetin e vendit?

Diplomacia për mua është arti i përfaqësimit. Sigurisht baza është patriotizmi dhe atdhedashuria, por me mëndje të hapur ndaj përqafimit së të ndryshmes, diversitetit dhe bashkëjetesës me botën e madhe. Sigurisht përfaqësimi me dinjitet i një historie dhe tradite identitare duhet ruajtur e trashëguar. Mbi të gjitha mbrojtja e integritetit të bashkatdhetarëve tanë të kudondodhur dhe asnjë kompromis me interesat e Atdheut.

Gjatë karrierës suaj keni shërbyer në misione diplomatike në Budapest dhe Bernë, si dhe keni mbuluar marrëdhëniet me Principatën e Lihtenshtajnit. Cilat kanë qenë sfidat më të rëndësishme të këtyre përvojave dhe çfarë mësimesh keni nxjerrë nga puna në mjedise të

ndryshme diplomatike e kulturore?

Me Hungarinë ka qenë eksperiencë e jashtëzakonshme si vendi i BE-së dhe ka shërbyer shumë si përvojë për integrimin. Ndërkohë atje kam kaluar sfidën më të madhe migratore të vitit 2015, që ka njohur ndonjëherë BE, ku teknika e mbrojtjes së kufijve të BE-së në atë dyndje humanitare migratore i gjeti krejt të papërgatitura institucionet. Ndërkohë eksperienca në Bern ishte një shkollë më vete e majës më të lartë të përfaqësimit të popullit nëpërmjet referendumit, si kulmi i demokracisë dhe harmonia e sistemit konfederativ të qeverisjes, ku në pushtet ishin të gjitha partitë me portofole të veçanta dhe kryetari i qeverisë bëhej me rotacioni automatik çdo vit.

Diplomacia kërkon përgatitje, maturi, aftësi komunikimi dhe njohje të thellë të interesave të palëve. Sipas përvojës suaj, cilat janë cilësitë thelbësore që duhet të ketë një diplomat dhe sa rëndësi kanë integriteti, profesionalizmi dhe besueshmëria në ndërtimin e marrëdhënieve ndërkombëtare?

Në fakt, kur e quajta art diplomacinë, mendoj se është diplomacia që e zgjedh diplomatin, pra kërkohet talenti dhe shumë përgatitje nga fusha të ndryshme. Duhet të njohësh historinë, pasi ngjarjet përsëriten në forma të ngjashme. Duhet të kesh kulturë të gjithanshme, pasi mund të gabosh. Protokolli ka një rëndësi të veçantë dhe asnjë detaj nuk duhet nënvlerësuar. Ftohtësia në gjykim është vendimtare, emocionet duhen mbajtur sa më larg, pasi nuk je ti, por është gjithçka që ti përfaqëson e që është shumë më e madhe se ti. Mbi të gjitha s'duhet humbur për asnjë çast arsyeja për të cilën ti je aty.

Gjatë veprimtarisë suaj jeni vlerësuar nga institucione dhe përfaqësues të vendeve mike. Si i përjetoni këto nderime dhe sa e shihni vlerësimin e një diplomati si një formë respekti edhe për vendin që ai përfaqëson?

Më ka ndihmuar shumë formimi im si historian dhe fakti që unë rrjedh nga një prej familjeve të vjetra të fisnikërisë evropiane të penetroj më lehtësisht në kancelaritë diplomatike. Të shijuarit e artit dhe bisedat që shpeshherë nisin me letërsinë bashkëkohore, ku mamaja ime, shkrimtarja Mira Meksi, ka shkruar dhe është botuar në disa vende, si Hungaria që unë kam shërbyer si diplomat, e ka thyer akullin e komunikimit. Nëpërmjet këtyre çelësave më është dhënë mundësia që puna ime teknike diplomatike të vihet më shumë re dhe për këtë arsye vlerësimet nga qeveritë e huaja për arritjet në punën time për të sjellë më pranë vendet tona të jetë me vizibilitet të lartë dhe po me aq rendiment.

Angazhimi juaj në Drejtorinë Konsullore të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme lidhet drejtpërdrejt me shërbimin ndaj qytetarëve. Cilat janë sfidat kryesore të diplomacisë konsullore sot dhe si mund të përmirësohet mbështetja për shqiptarët që jetojnë, punojnë apo studiojnë jashtë vendit?

Drejtoria Konsullore është drejtoria operacionale e Ministrisë së Jashtme. Porta ku trokasin gjithë shqiptarët dhe të huajt në çdo moment dhe ka intensitet shumë të lartë pasi problematikat janë nga më të ndryshmet. Me vizën elektronike dhe digjitalizimin e shërbimeve konsullore mendoj se i është dhënë përgjigje çdo qytetari në kohë reale në çdo cep të botës, duke i kursyer kohë, mund dhe para. Sigurisht që për sfida të tjera jemi ende në proces si digjitalizimi i më shumë shërbimeve e deri tek masivizimi i Ambasadës digjitale dhe digjitalizimi i legalizimit të dokumenteve për përdorimin jashtë vendit.

Migracioni dhe lufta kundër trafiqeve të paligjshme janë ndër fushat ku keni dhënë kontribut profesional. Si mund të harmonizohen mbrojtja e të drejtave të njeriut, siguria, parandalimi i trafikimit dhe përafrimi i legjislacionit shqiptar me standardet e Bashkimit Evropian?

Strategjia Kombëtare e Migracionit është kthyer në një platformë dhe dokument strategjik të jashtëzakonshëm me një gjithëpërfshirje institucionale me një koordinim aq frytdhënës sa vërtet e them që vendi ynë është në standardet evropiane. Gjithë sekreti mendoj është difuzioni i informacionit tek qytetarët, ku të ndahet e vërteta nga abuzimi, të drejtat e tyre dhe detyrimet, si dhe një orientim i duhur për migrimin e ligjshëm dhe të sigurt duke qenë se shumë shpejt do jemi pjesë e familjes së madhe evropiane dhe lëvizshmëria është një nga të mirat kryesore të gjithë platformës.

Përvoja juaj në diplomacinë ekonomike, promovimin kulturor dhe ekspertizën financiare, ju ka dhënë mundësinë t'i shihni marrëdhëniet ndërkombëtare nga disa këndvështrime. Çfarë duhet të bëjë Shqipëria për ta kthyer diplomacinë në një instrument edhe më efektiv për tërheqjen e investimeve, promovimin e turizmit, zhvillimin e eksporteve dhe njohjen e kulturës shqiptare?

Diplomacia ekonomike mendoj se është një nga shtyllat kryesore të diplomacisë moderne, pasi ekonomia është gjuha që e flasin të gjithë. Duke parë orientimin e politikave ekonomike të resurseve që ka vendi ynë, si dhe sektorët prioritarë si ai bujqësor, apo turizmi, për më tepër mundësitë dhe shpejtësinë e të regjistruarit të një biznesi në vend dhe politikat fiskale mjaft të përshtatshme për investimet e huaja, e bëjnë Shqipërinë akoma dhe më shumë atraktive. Sigurisht pozicioni gjeografik dhe klima e favorshme ka ngjallur mjaft



interes dhe për diplomacinë ekonomike tashmë puna është shtuar dhe sfidat e reja e bëjnë mjaft interesante ndërthurjen e promovimit të tregut tonë që çdo ditë po përshtatet me atë evropian e ndërkombëtar dhe promovimit të vlerave më të mira kulturore dhe traditës tonë.

Siguria, institucionet dhe edukimi profesional

Duke ndërthurur përvojën diplomatike, angazhimin në mësimdhënie, kontributin në koordinimin ndërinstitucional për përballimin e emergjencave dhe vlerësimin tuaj me gradën honorifike "Kolonel" për arritjet si sportist elitar, si e shihni përgjegjësinë tuaj në përcjelljen e dijes te brezat e rinj, në forcimin e sigurisë dhe qëndrueshmërisë kombëtare, si dhe në promovimin e vlerave të profesionalizmit, disiplinës dhe përgjegjësisë qytetare në shoqërinë shqiptare?

Për mua ka një domethënie shumë përmbushëse grada "Kolonel", e cila ka harmonizuar traditën time familjare prej shekujsh si luftëtar në Principatat e Arbrit përkrah Heroit tonë Kombëtar, në Luftën e Vlorës dhe themelues të Ushtrisë së Parë Shqiptare, e deri në LANÇ me disa Dëshmorë të Atdheut, ku Çeta Partizane e Jugut të Shqipërisë u quajt "Çeta Prokop Meksi". Gjithashtu dhe nga krahu amësor, Stërgjyshi im, i njohur në Historinë e Shqipërisë si "Prifti me Kobure", At Irakli Pylli, patrioti i germave shqipe që luftoi në Epopenë e Vlorës dhe ra Dëshmor për Lirinë e Shqipërisë.

Gjithashtu trajnimet në akademitë më në zë ushtarake dhe të zbatimit të ligjit, por dhe eksperienca si kampion kombëtar dhe ndërkombëtar në sporte luftarake, në sportet e forcës dhe në qitjen me armë luftarake, përveç titullit botëror në Bodybuilding&Fitness e kompletojnë figurën time ushtarake.

Fakti që shërbej pranë Shtabit të Forcave të Armatosura dhe si Koordinator i Ministrisë së Jashtme pranë Agjencisë së Mbrojtjes Civile i jep zbatueshmëri dhe një kuptim përgjegjësisë në praktikë të gradës "Kolonel".

Ky vlerësim për sportistët elitarë është një nismë e jashtëzakonshme e qeverisë, të cilën unë personalisht e kam marrë me shumë angazhim, duke qenë eficent në kontribut për të ndarë eksperiencën profesionale dhe sportive 30-vjeçare me ushtarakët e rinj të FA-së, nëpërmjet mësimdhënies në Akademinë e Mbrojtjes.

Sporti elitar, disiplina dhe suksesi ndërkombëtar

Për më shumë se 25 vjet, sporti ka qenë një pjesë e rëndësishme e jetës suaj. Si nisi rrugëtimi në bodybuilding dhe fitness dhe çfarë ju shtyu ta shndërronit këtë pasion në një angazhim serioz e kompetitiv?

Bodybuilding&Fitness është kultura sportive nga më të vjetrat në histori, mjafton të kujtojmë trupat e skalitur të gladiatorëve apo mënyrën se si grekët e lashtë i përfytyronin perënditë dhe kryesisht ato luftarake të reflektuara në skulpturat antike. Është baza e çdo sporti tjetër. E pra kjo dashuri për harmoninë muskulore dhe kalitje vullneti, që nuk të lejon të limitohesh, por ta kalosh nga pasioni në profesion dhe të përballesh me të ngjashmit e tu në skenat e mëdha botërore.

Në vitet 2007–2008 arritët rezultate në kategorinë Junior dhe morët pjesë në gara ballkanike, mesdhetare e evropiane. Çfarë kujtoni nga ajo periudhë dhe si ndikuan përvojat e para ndërkombëtare në vendosmërinë tuaj për të synuar nivele më të larta?

Sigurisht, çdo garë është eksperiencë më vete, llogarit që garat dhe fitoret e mia janë më dhjetëra në disa sporte, por ajo që kujtoj nga këto gara të bodybuilding edhe pse dola finalist, nuk isha në më të mirën time, por në ato kohë ne ishim thuajse pionierë të këtij sporti dhe nëse nuk do shkonim në kampionate ndërkombëtare do të penalizohej Shqipëria dhe rrezikohej të mos vinin më ftesa. Duke marrë pjesë në kaq shumë gara diku me dëshirë dhe diku i imponuar për këto motive, bëhesh një profesionist i vërtetë dhe ndjek rrugëtimin deri në majë.

Gjatë shërbimit në Budapest, sipas të dhënave të karrierës suaj, fituat për gjashtë vite radhazi kampionatin e qitjes me armë luftarake në Hungari. Si arritët të ndërthurnit përgjegjësitë diplomatike me përgatitjen sportive dhe çfarë kërkon një disiplinë e tillë në aspektin e përqendrimit, kontrollit dhe vetë-disiplinës?

Qitja me armë luftarake përtej talentit kërkon vetëm praktikë pafund. Qetësia e brendshme dhe momentum janë pikat më nevralgjike të kësaj disipline. Të dyja janë po aq të rëndësishme dhe në diplomaci dhe sa më shumë i praktikon, duket sikur stërvitin njëra-tjetrën.

Ju jeni angazhuar edhe në powerlifting, mundje krahu, strongman dhe disiplina të tjera të sporteve të forcës dhe sporteve luftarake. Çfarë ju tërheq te këto sporte dhe çfarë ju kanë mësuar ato për kufijtë fizikë, forcën mendore dhe qëndrueshmërinë e karakterit?

Forca është dhunti, por stërvitja sistematike e rrit atë, në një kombinim alimentacioni, nutricioni dhe regjimi e sistematike, njeriu arrin në më të mirën e tij, por teknika është sekreti i çdo sporti. Pra kur trinomi mëndje, shpirt, trup vendosen në unisonitet, limitet relativizohen dhe ti merr kontrollin e plotë të qenies tënde dhe arrin balancat dhe qëndrueshmërinë ndaj çdo lloj sfide.

Një prej arritjeve tuaja më të rëndësishme ishte suksesi në kompeticionin botëror "Diamond Cup Lesufonia&Elite Pro World Championshio" në Portugali, në kategorinë Men's Classic Bodybuilding deri në 180 centimetra, si dhe vendi i katërt në kategorinë absolute. Çfarë përfaqësoi ky rezultat për ju dhe përfaqësimin e sportit shqiptar në arenën ndërkombëtare?

Të jesh Kampion Bote në Ligën Profesioniste të Federatës zyrtare Botërore të Bodybuilding&Fitness IFBB është maja e një karriere sportive dhe shpërblimi i 30 viteve karrierë sportive të pandërprerë. Nder të ngresh Flamurin Kombëtar në majën e botës sportive dhe mos harrojmë masiviteti i këtij sporti është nga më të lartët. Përgjegjësi e madhe për të mbajtur këtë titull të cilin e kam vënë në shërbim të sportit në vendin tonë dhe të brezave të rinj. Kampion nuk do të thotë të ngresh një apo disa kupa dhe kaq, por eksperienca jote të vihet në shërbim të shoqërisë civile, duke sjellë sportin dhe jetën e shëndetshme në komunitet.

Për kontributin dhe rezultatet tuaja sportive jeni nderuar me titullin "Mjeshtër i Madh" nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, si dhe me vlerësime të tjera institucionale. Çfarë ndjesie ju krijon fakti që një arritje personale sportive shndërrohet në një burim krenarie për vendin dhe në një motivim për sportistët e tjerë?

Të them të drejtën, përtej modestisë, kam marrë gjithë nderimet e mundshme nga shteti ynë dhe shumë shtete të tjera në të gjitha nivelet institucionale, edhe si sportist dhe si diplomat. Vlerësimet më kanë përmbushur por dhe rëndojnë plumb, pasi duket sikur shtohen detyrimet dhe përgjegjësitë.

Në vitin 2023 u angazhuat si zyrtar i Federatës Ndërkombëtare të Bodybuilding dhe Fitnessit (IFBB), si dhe si Master of Ceremonies në kompeticione ndërkombëtare. Çfarë ndryshon kur kaloni nga roli i sportistit që synon fitoren personale te përgjegjësia për organizimin dhe promovimin e sportit në nivel ndërkombëtar?

Në këtë vit mu akordua Medalja e Artë nga Presidenti i Federatës Botërore të Bodybuilding&Fitness si sportist dhe si zyrtar kur bëhen ndarjet vjetore, pra në analogji me football-in është si "Topi i Artë. Gjithashtu u bëra zyrtar i lartë i kësaj federate dhe m'u besua drejtimi i kampionateve evropian e botëror. Rëndësia e gjithë këtij procesi ishte përfaqësimi i Shqipërisë për herë të parë në këto nivele, mundësia për të lobuar për sportistët tanë dhe mbrojtja e të drejtave të tyre sportive në arenën ndërkombëtare, duke patur parasysh sa e fortë është konkurrenca.

Në bashkëpunim me organizatorë dhe partnerë sportivë, keni kontribuar në zhvillimin e kompeticioneve ndërkombëtare në bodybuilding dhe fitness, powerlifting dhe mundje krahu. Çfarë mundësish krijojnë këto aktivitete për sportistët shqiptarë dhe si mund të ndihmojnë në zhvillimin e një tradite të qëndrueshme në sportet e forcës?

Ndihem vërtet i realizuar në misionin tim për t'i kthyer borxhin vendit tim, Shqipërisë. Kam dhënë gjithçka për sportet e forcës, duke filluar nga organizimi në Shqipëri i kampionateve ndërkombëtare nga më të bukurit në botën e këtyre sporteve, tek lobimi për të gjithë sportistët, sponsorizime, promovimi i sportit dhe sportistëve në pjesën mediatike dhe krijimin e gjithë infrastrukturës për të patur një rrugë të shtruar si në aspektit logjistik ashtu dhe në eksperiencën që kam ndarë me këdo. Qëllimin që kisha në kontributin tim modest në masivizimin e këtyre sporteve të forcës, mendoj se është arritur deri diku, duke thyer shumë tabu dhe paragjykime, sot e shikojmë se si fitness-i është kthyer ne trend për të rinjtë e të rejat në vend.



Imazhi juaj sportiv është përdorur në hapësira publike dhe pranë institucioneve të ndryshme, në funksion të promovimit të sportit dhe jetesës së shëndetshme. Si e vlerësoni fuqinë e shembullit personal në motivimin e të rinjve dhe çfarë mesazhi dëshironi t'u përcillni atyre që e shohin sportin si një rrugë drejt suksesit?

Pjesë e një fushatë promovimi për sportin dhe jetën e shëndetshme mund të konsiderohet dhe vendosja e imazhit tim sportiv si në institucione arsimore sportive, ashtu dhe në ato të forcave të armatosura. Përtej nderimit tim, mendoj se krijon një nxitje vizive, sidomos në masivizim sportiv në vendosjen e imazhit tim sportiv nga Bashkia Tiranë në fasada të ndryshme në pika kyçe në Kryeqytet.

Gjirokastra, familja Meksi dhe trashëgimia historike shqiptare

Këshilli Bashkiak i Gjirokastrës ju ka akorduar titullin "Qytetar Nderi i Gjirokastrës", në vlerësim të kontributit tuaj në promovimin e sportit dhe jetesës së shëndetshme në komunitet. Çfarë domethënieje ka për ju ky titull dhe si e përjetoni këtë vlerësim në qytetin me të cilin familja juaj ka lidhje të hershme historike?

Në një qytet me aq traditë dhe kontribut, por dhe qyteti i origjinës të familjes time, mendova të jepja kontributin tim në organizimin prej një dekade të kampionateve kombëtare të bodybuildingut natyral në këtë qytet, me qëllim që rinia e "qytetit të gurtë" të angazhohej në jetën sportive dhe të ishte sa më vitale. Me këtë motivacion Këshilli Bashkiak më nderoj me titullin "Qytetar Nderi"

Ju jeni studiues i historisë dhe heraldikës shqiptare, me interes të veçantë për familjen Meksi. Si lindi dëshira për të hulumtuar historinë e familjes suaj dhe në ç' moment ky interes personal u shndërrua në një angazhim më të gjerë për njohjen dhe dokumentimin e trashëgimisë kombëtare?

Jam rritur me studimet e prof. Aleksandër Meksi dhe prof. Fedhon Meksi mbi familjen Meksi për kontributin e tyre si paraardhës së Despotëve të Artës me Gjeneralin më të famshëm që ka njohur bota antike Mërkur Bua, i cili luftoi kundra mbretërve të mëdhenj të Evropës dhe fitorja shkonte në anën e tij. Më pas Meksajt i gjejmë në repartet ushtarake të Komneneve të fuqishëm, dhe përkrah Heroit tonë Kombëtar, Gjergj Kastrioti, gjithashtu shquhet Petro Meksi, Komisari i Lidhjes së Prizrenit, e më pas në Luftën e Vlorës. Lufta Nacional Çlirimtare i gjeti shumë aktiv, ku janë disa Dëshmorë të Atdheut nga kjo familje.

Në historinë e familjes Meksi përmenden kontribute në diplomaci, drejtësi, politikë, kulturë dhe veprimtari kombëtare, si dhe figura të tilla si Vangjel Meksi, i njohur për përkthimin e Dhiatës së Re dhe veprimtarinë gjuhësore. Cilat janë kontributet historike që mendoni se meritojnë të njihen më shumë nga publiku dhe si mund të sigurohet dokumentimi i tyre i saktë për brezat e ardhshëm?

Materiale të shumta kam patur mundësi të siguroj nga arkiva të huaja ku tregojnë se Arbëria ka patur familjet e saj fisnike të barabitura me ato të fisnikërisë evropiane. Familja blazoniere Meksi, përmendet që në shek.. XI në katalogun e familjeve fisnike me kontribut të shquar në vend, por dhe në Evropën e asaj kohe kryesisht si Stratiot (Gjeneral me ushtritë e tyre që ofronin shërbime ushtarake). Madje në Malin e Shenjtë Athos ekziston Kodeksi Bizantin i Arkondëve Meksi shek. XII-XIV.

Në periudhën më të vonë dhe që vlen të përmendet janë Diplomati Kristo Meksi, Delegat i Aktit të Pavarësisë, ku bashkë me Luigj Gurakuqin pritën Ismail Qemalin në Bukuresht nga ku nisi gjithçka për krijimin e shtetit të parë shqiptar. Polo Meksi, gur themeli i sistemit tonë të drejtësisë, Jorgji Meksi, themeluesi i gazetarisë shqiptare, Doktor Vangjel Meksi, i cili shqipëroi në 1827 Dhjatën e Re dhe i njohur për Alfabetin e Meksit, Kundëradmirali Dhimitër Meksi, e një personalitet shumë i spikatur, filantropi i madh, i cili themeloi një nga shkollat e para shqipe në vend dhe themeluesi i Lojërave Olimpike Moderne Vangjel Zhapa, i biri i Sotira Meksit. Të shumtë kanë qenë dhe Meksaj që kanë lënë gjurmë në historinë e botës si, Nikolla Meksi, Guvernatori i Venedikut në Peloponez; Peshkopi Bernardo de Mexi, Përfaqësuesi i Perandorisë së Shenjtë Romake në Angli; Jorgo Meksi, Kapedani i Athinës i cili mori në dorëzim Akropolin nga Turqit; Gjenerali i famshëm i revolucionit grek, Kristodul Meksi; Ioanis Meksi, Heroi i Luftës Greko-Turke etj., personalitete të spikatura të Evropës në politikë, diplomaci, shkencë e art.

Vlerësimet, përgjegjësia qytetare dhe mesazhi për brezat e rinj

Krahas titullit "Qytetar Nderi i Gjirokastrës" dhe "Mjeshtër i Madh", ju janë dhënë edhe vlerësime të tjera, ndër to "Mirënjohja e Kryeqytetit" dhe nderime nga institucione shqiptare e të huaja. Cili prej këtyre vlerësimeve ka një domethënie të veçantë për ju dhe çfarë përgjegjësie sjellin nderimet publike për personin që i merr?

Sigurisht që vlerësimet në vendin tënd janë ato që kanë më vlerë emocionale, por nga vlerësime të huaja që janë vërtet të rralla është "Urdhri i Trimërisë" i akorduar nga Arkiduka Habsburg i Austrisë dhe Princi i Hungarisë, i konsideruar si Urdhri më i lartë ushtarak dhe civil i Habsburgëve, të cilin ia jepnin Heronjve të Luftës pas traktatit të Trianonit. Duke qenë i angazhuar në rrjetin e fisnikërisë evropiane dhe për kontribut të shquar në marrëdhëniet mes vendeve tona, mu akordua nga Komisioni i Titujve dhe Gradave.

Duke parë rrugëtimin tuaj nga diplomacia dhe shërbimi publik te sporti elitar dhe studimi i historisë, cili ka qenë mësimi më i rëndësishëm që keni nxjerrë nga sfidat e jetës? Dhe si keni arritur të ruani ekuilibrin mes përgjegjësive profesionale, përgatitjes sportive dhe interesave tuaja studimore?

Kërkohet disiplinë dhe përqendrim, por mbi të gjitha vendosmëri dhe asnjëherë mos të heqësh dorë nga synimet. Atdhedashuria dhe altruizmi janë vlerat më të mëdha që mund të ketë njeriu. Dua ta mbyll me shprehjen e Stërgjyshit tonë Patriotit dhe Dëshmorit të Atdheut, At Isaia, "Unë besoj në Zot, Abetare dhe Komb - këto janë Ati, Biri dhe Shpirti i Shenjtë".

Nëse do t'u drejtonit një mesazh të rinjve shqiptarë që ëndërrojnë të ndërtojnë një karrierë të suksesshme në Shqipëri dhe jashtë saj, por përballen me vështirësi e pasiguri, çfarë do t'u thoshit për rëndësinë e dijes, disiplinës, këmbënguljes dhe dashurisë për vendin? Dhe, mbi të gjitha, çfarë do të dëshironit të mbetej si trashëgimia juaj përtej titujve, medaljeve dhe arritjeve personale?

Shprehja "Guri i rëndë në vend të vet" është kështilla ime. Edhe pse ne shumë shpejt do jemi pjesë e familjes së madhe evropiane, sërish jam fanatik i idesë së kontributit në Shqipëri. Përtej çdo sfide unë besoj në destin dhe çdokush ka dritën e tij për të cilën duhet të luftojë me vendosmëri dhe asgjë mos ta ndali.

Trashëgimia ime përtej titujve, do doja të isha sadopak pjesë kontributore e asaj që nisën ndër shekuj paraardhësit e mi, përcjelljen e dritës atje ku ka errësirë, për të cilën po shkruaj dhe një libër që do marrë jetë brenda këtij viti.

Regjimenti i Operacioneve Speciale: Elita që bashkon guximin, profesionalizmin dhe besnikërinë ndaj atdheut

Nga Batalioni i Operacioneve Speciale te një strukturë elitare e Forcave të Armatosura, historia e një formacioni që e ka ndërtuar identitetin mbi përgatitjen, qëndrueshmërinë dhe misionin



Për ushtarakët fjala detyrë merr një kuptim të veçantë. Ata stërviten për të përballuar situata të vështira, mësohen të veprojnë nën presion dhe përgatiten për misione ku vendimmarrja, vetëkontrolli dhe besimi te shoku i armëve janë po aq të rëndësishme sa forca fizike. Për ta, profesionalizmi nuk është një titull, por një standard që duhet dëshmuar çdo ditë. Përgatitja nuk është një fazë që përfundon me marrjen e një certifikimi, por një proces i vazhdueshëm. Dhe uniforma nuk është thjesht shenjë përkatësie, por përgjegjësi ndaj vendit, institucionit dhe njerëzve që u kanë besuar sigurinë.

Në këtë filozofi shërbimi mishërohet edhe rrugëtimi i Regjimentit të Operacioneve Speciale (R.O.S.), një prej formacioneve elitare të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Historia e tij është histori e përgatitjes së lartë profesionale, e kapërcimit të kufijve individualë, e bashkëpunimit dhe e përshtatjes me kërkesat e një mjedisi sigurie që ndryshon vazhdimisht.

Përtej emrit, uniformës dhe simbolikës që e dallon, vlera e këtij formacioni qëndron te njerëzit që e përbëjnë, te kultura e punës që ndërtojnë dhe te gatishmëria për të përmbushur detyrat që u ngarkohen. Sepse një njësi elitare nuk përcaktohet vetëm nga vështirësia e përzgjedhjes, por mbi të gjitha nga cilësia e personelit, disiplina, integriteti, aftësia për të vepruar si ekip dhe përgjegjësia me të cilën përfaqëson Forcat e Armatosura.

Nga Batalioni te Regjimenti,
një histori zhvillimi dhe transformimi

Rrugëtimi institucional i Operacioneve Speciale në Shqipëri mori një shtysë të rëndësishme në vitin 1999, me krijimin e Batalionit të Operacioneve Speciale (B.O.S.), në një periudhë kur zhvillimet e sigurisë në rajon kërkonin aftësi të veçanta ushtarake dhe një nivel të lartë gatishmërie. Situata gjeopolitike e kohës, konfliktet në rajon dhe nevoja për të përballuar sfida komplekse e bënë të domosdoshëm zhvillimin e kapaciteteve të specializuara.

Që në fillesat e tij, ky formacion u përball me kërkesa të larta për përgatitje dhe qëndrueshmëri. Angazhimet në mjedise të vështira, bashkëpunimi me struktura të tjera dhe nevoja për t'iu përshtatur situatave të ndryshme ndihmuan në formimin e përvojës së tij profesionale. Me kalimin e viteve, zhvillimi i kapaciteteve dhe zgjerimi i përgjegjësive krijuan kushtet për një etapë të re institucionale.

Më 4 mars 2021, Batalioni i Operacioneve Speciale kaloi në nivelin e Regjimentit të Operacioneve Speciale. Ky transformim shënoi një moment të rëndësishëm në zhvillimin organizativ të formacionit dhe në rrugën e konsolidimit të kapaciteteve të operacioneve speciale të Forcave të Armatosura.

Kalimi nga batalioni në regjiment nuk është thjesht ndryshim emërtimi. Ai lidhet me zhvillimin e strukturës, organizimin e kapaciteteve dhe mundësinë për të përballuar një spektër më të gjerë përgjegjësish, në përputhje me nevojat e institucionit dhe objektivat e modernizimit. Në një forcë ushtarake, zhvillimi organizativ merr vlerë kur shoqërohet me personel të përgatitur, drejtim profesional, pajisje të përshtatshme dhe aftësi për të vepruar në bashkëveprim me strukturat e tjera.

Në këtë kuptim, historia e ROS është edhe një pasqyrë e zhvillimit të Forcave të Armatosura shqiptare: nga ndërtimi i kapaciteteve të specializuara te përpjekja për të konsoliduar standardet, për të përmirësuar përgatitjen dhe për të forcuar ndërveprueshmërinë me aleatët.

Një histori e tillë nuk ndërtohet brenda natës. Ajo kërkon vite pune, përvojë të grumbulluar, mësime të nxjerra dhe gatishmëri për t'u përmirësuar. Çdo brez i formacionit trashëgon një përgjegjësi të veçantë: të ruajë standardet e krijuara dhe t'i zhvillojë më tej, duke u përgatitur për sfidat që sjell koha.

Përvoja në misione, një shkollë e profesionalizmit

Për një formacion të operacioneve speciale, përvoja është një nga elementet më të rëndësishme të zhvillimit profesional. Ajo krijohet përmes stërvitjes së vazhdueshme, por pasurohet edhe nëpërmjet bashkëpunimit, angazhimeve ndërkombëtare dhe përballjes me mjedise të ndryshme operacionale.

Në historikun e Batalionit të Operacioneve Speciale përfshihen angazhime që lidhen me zhvillimet e sigurisë në rajon, si dhe pjesëmarrja e personelit shqiptar në operacionet ndërkombëtare në Afganistan dhe Irak. Këto përvoja përfaqësojnë pjesë të rëndësishme të historisë së kontributit shqiptar në përpjekjet e përbashkëta për siguri.

Gjatë periudhës së konfliktit në Kosovë, në vitin 1999, dhe të krizës në Maqedoninë e Veriut, në vitin 2001, personeli i batalionit u përfshi në angazhime përgjatë kufijve rajonalë. Më pas, në vitin 2002, efektivë shqiptarë u angazhuan në Afganistan, ndërsa në vitin 2004 Shqipëria dërgoi personel në Irak, në kuadër të operacionit ndërkombëtar të kohës. Në vitin 2010, një detashment shqiptar u vendos në Kandahar të Afganistanit, në një periudhë kur angazhimi i kontingjenteve shqiptare në këtë vend kishte marrë një dimension të rëndësishëm operacional.

Këto etapa duhen parë në kontekstin e tyre historik dhe të misioneve konkrete ku u përfshinë kontingjentet shqiptare. Ato dëshmojnë një periudhë të rëndësishme të zhvillimit të përvojës ndërkombëtare të personelit ushtarak shqiptar dhe të marrëdhënieve të tij profesionale me forcat aleate.

Angazhimet jashtë vendit kërkojnë përshtatje me procedura, standarde dhe mënyra të ndryshme bashkëveprimi. Ato vënë në provë aftësinë për të punuar në ekipe shumëkombëshe, për të komunikuar në kushte komplekse dhe për të ruajtur disiplinën e vendimmarrjes në mjedise të vështira. Përvoja e fituar në këto angazhime mund të shërbejë si bazë për përmirësimin e stërvitjes, zhvillimin e kapaciteteve dhe forcimin e ndërveprueshmërisë.

Por përvoja operacionale nuk matet vetëm me numrin e misioneve apo me vendet ku është shërbyer. Ajo matet edhe me mësimet që nxirren, me aftësinë për t'i kthyer përvojat në njohuri dhe me mënyrën se si këto njohuri përfshihen në përgatitjen e brezave të rinj.

Për këtë arsye, historia e angazhimeve të personelit të Operacioneve Speciale është një burim i rëndësishëm për të kuptuar zhvillimin profesional të formacionit dhe kontributin e tij në rrugëtimin e Forcave të Armatosura shqiptare.

Çdo përvojë e fituar në bashkëpunim me aleatët është një mundësi për të mësuar, për t'u përshtatur dhe për të rritur standardet. Në këtë proces, profesionalizmi i efektivëve shqiptarë përfaqëson jo vetëm një përgjegjësi individuale, por edhe imazhin e institucionit dhe të vendit që ata përfaqësojnë.

Përzgjedhja dhe stërvitja:
rruga që formon një operator special

Pas çdo formacioni elitar qëndron një proces i kërkuar përzgjedhjeje dhe përgatitjeje. Në operacionet speciale, aftësitë fizike janë të domosdoshme, por nuk mjaftojnë të vetme.



Ato duhet të shoqërohen me qëndrueshmëri psikologjike, vetëkontroll, aftësi për të bashkëpunuar, përgjegjësi dhe gatishmëri për të mësuar vazhdimisht.

Përzgjedhja e personelit për këtë fushë synon të identifikojë individë që mund t'u përgjigjen kërkesave të larta të shërbimit. Procesi vlerëson përgatitjen fizike, aftësitë profesionale dhe qëndrueshmërinë përballë vështirësive, ndërsa trajnimi pasues synon të zhvillojë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për detyrat e specializuara.

Në këtë rrugë, çdo kandidat përballet me nevojën për të njohur kufijtë e vet dhe për të punuar sistematikisht për t'i përmirësuar. Qëndrueshmëria nuk nënkupton vetëm aftësinë për të përballuar lodhjen, por edhe ruajtjen e përqendrimit, zbatimin e procedurave dhe marrjen e vendimeve të përgjegjshme në kushte presioni.

Një rëndësi të veçantë ka puna në ekip. Në një formacion special, aftësia individuale merr kuptim të plotë kur ndërthuret me besimin, koordinimin dhe përgjegjësinë e përbashkët. Suksesi i një detyre nuk varet vetëm nga aftësia e një individi, por nga gatishmëria e të gjithë ekipit për të vepruar në përputhje me objektivin dhe për të mbështetur njëri-tjetrin.

Megjithatë, përgatitja e një operatori special nuk është vetëm çështje e aftësive fizike dhe teknike. Ajo përfshin edhe etikën ushtarake, respektimin e ligjit, kuptimin e përgjegjësisë ndaj civilëve dhe zbatimin e rregullave të angazhimit. Profesionisti i vërtetë nuk vlerësohet vetëm nga aftësia për të vepruar, por edhe nga gjykimi me të cilin vepron dhe përgjegjësia që tregon në çdo rrethanë.

Përgatitja e lartë është një proces pa fund. Teknologjitë



ndryshojnë, kërcënimet evoluojnë dhe mjedisi i sigurisë bëhet gjithnjë e më kompleks. Për këtë arsye, trajnimi duhet të jetë i vazhdueshëm, i përshtatur me kërkesat e kohës dhe i orientuar drejt zhvillimit të aftësive individuale e kolektive.

Stërvitja e vazhdueshme krijon bazën për këtë bashkëveprim. Ajo zhvillon aftësitë, forcon disiplinën dhe ndihmon në ndërtimin e një kulture ku standardet nuk konsiderohen si kufiri i përpjekjes, por si pikënisja e përmirësimit të mëtejshëm.



Kjo është një nga veçoritë që e dallon një formacion elitar: gatishmëria për të mos u kënaqur me atë që është arritur, por për të punuar vazhdimisht për standarde më të larta.

Njerëzit pas beretës, forca që nuk shihet gjithmonë

Bereta ngjyrë gështenjë dhe shenjat dalluese janë elemente të identitetit të Regjimentit të Operacioneve Speciale. Por simbolika e uniformës merr kuptim të plotë vetëm përmes përgjegjësisë së atyre që e mbajnë.

Pas çdo efektivi qëndrojnë orë të gjata stërvitjeje, përgatitje e vazhdueshme, përpjekje për të ruajtur formën fizike dhe profesionale, si dhe një angazhim që shpesh kërkon sakrifica personale e familjare. Në jetën e një ushtaraku të forcave speciale, gatishmëria nuk është vetëm një kërkesë e detyrës, por pjesë e mënyrës së të jetuarit dhe e përgatitjes për situata që mund të kërkojnë përgjigje të shpejtë e profesionale.

Në këtë realitet, vlerat e karakterit kanë rëndësi të veçantë. Integriteti, vetë-disiplina, besimi, përgjegjësia dhe respekti për shokun e armëve janë pjesë e themelit mbi të cilin ndërtohet një ekip i qëndrueshëm. Asnjë aftësi individuale nuk mund ta zëvendësojë bashkëpunimin, asnjë pajisje nuk mund ta zëvendësojë përgatitjen dhe asnjë simbol nuk mund ta zëvendësojë përgjegjësinë.

Për këtë arsye, historia e suksesit të ROS duhet të tregojë edhe historinë e njerëzve të tij. Ajo duhet të njohë kontributin e brezave që kanë ndërtuar përvojën e formacionit, të drejtuesve që kanë mbajtur përgjegjësi dhe të efektivëve që vazhdojnë të punojnë për ruajtjen e standardeve profesionale.

Vlerësimi i këtyre njerëzve nuk ka të bëjë me krijimin e një figure të idealizuar, por me njohjen e punës, përkushtimit dhe profesionalizmit që kërkon ky shërbim. Një histori suksesi është më bindëse kur mbështetet te përvoja konkrete, te rezultatet e dokumentuara dhe te vlerat që dëshmohen në praktikë.

Një mision që vazhdon

Në një botë ku sfidat e sigurisë ndryshojnë vazhdimisht, Forcat e Armatosura kanë nevojë për struktura të përgatitura, fleksibël dhe të afta për të vepruar në përputhje me detyrat që u ngarkohen. Operacionet Speciale janë pjesë e kësaj arkitekture të kapaciteteve ushtarake dhe kërkojnë investim të vazhdueshëm në personel, stërvitje, drejtim, pajisje dhe ndërveprueshmëri.

Për Regjimentin e Operacioneve Speciale, e ardhmja ndërtohet mbi përvojën e fituar, por nuk kufizohet prej saj. Ajo kërkon përshtatje ndaj zhvillimeve teknologjike, përmirësim të vazhdueshëm të aftësive dhe ruajtje të standardeve që e bëjnë të besueshëm një formacion elitar.

Në këtë rrugëtim, vlera më e madhe mbetet njeriu: ushtaraku



i përgatitur, i disiplinuar dhe i vetëdijshëm për përgjegjësinë që mbart. Është ai që e kthen stërvitjen në aftësi, përvojën në njohuri dhe bashkëpunimin në forcë të përbashkët.

Historia e ROS është një kapitull i rëndësishëm i zhvillimit të kapaciteteve të specializuara të Forcave të Armatosura shqiptare. Nga krijimi i batalionit në vitin 1999, te transformimi në nivel regjimenti në vitin 2021, ky rrugëtim pasqyron përpjekjen për të ndërtuar një formacion të aftë për t'iu përgjigjur kërkesave të kohës.

Për gazetën "Ushtria", pasqyrimi i kësaj historie është një mundësi për të vlerësuar profesionalizmin, përkushtimin dhe përgjegjësinë e një strukture që përfaqëson një pjesë të rëndësishme të kapaciteteve të Forcave të Armatosura.

Sepse elita ushtarake nuk ndërtohet vetëm mbi aftësinë për të përballuar sfidat më të vështira. Ajo ndërtohet mbi karakterin, dijen, disiplinën dhe besimin se çdo detyrë kërkon përgatitjen më të mirë të mundshme.

Regjimenti i Operacioneve Speciale, një histori e ndërtuar mbi përgatitjen, e forcuar nga përvoja dhe e orientuar drejt misionit.

Profesionalizëm në përgatitje. Përgjegjësi në shërbim. Gatishmëri për misionin.

RESUL BEDO, PARTIZANI, USHTARAKU MADHOR DHE SHKRIMTARI QË I LA YJET TË PASHUARA

Në 100-vjetorin e lindjes së luftëtarit të LANÇ-it dhe autorit të serisë së njohur "Yje të pashuar", nderim për njeriun që ia kushtoi jetën kujtesës së dëshmorëve të Atdheut



PROF. ASOC. DR. ZAHO GOLEMI



Nga Fushëbardha në rreshtat e luftës partizane

Resul Arshi Bedo, i njohur si Resuli, lindi më 16 gusht 1926, në Fushëbardhë të Gjirokastrës, në një trevë me tradita të shquara atdhetarie, qëndrese dhe sakrifice. Jeta e tij u lidh herët me historinë e vendit dhe me përpjekjet e popullit shqiptar për liri. Kur Shqipëria u pushtua nga Italia fashiste, ai ishte vetëm 13 vjeç, ndërsa pak vite më vonë, ende në moshë të re, u rreshtua në çetën "Çerçiz Topulli", të krijuar në Fushëbardhë, më 12 dhjetor 1942.

Më pas, Resul Bedo u bë pjesë e batalionit "Asim Zeneli" dhe e Brigadës VI Sulmuese, duke përjetuar nga afër luftime të rëndësishme të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Rruga e tij luftarake u shtri nga malet e Jugut në Shqipërinë e Mesme e të Veriut, deri në Mal të Zi, Kosovë, Maqedoni e Bosnjë. Ishte një përvojë që do të linte gjurmë të pashlyeshme në jetën e tij dhe do të përcaktonte edhe misionin e ardhshëm si shkrimtar.

Për Resul Bedon, lufta nuk ishte thjesht një kapitull i përfunduar i historisë. Ajo ishte kujtesa e shokëve të armëve, e betejave, e sakrificave dhe e atyre që nuk u kthyen më pranë familjeve të tyre. Ai e njihte nga afër çmimin e lirisë dhe e kuptonte se pas çdo emri dëshmori qëndronte një jetë e ndërprerë, një familje në dhimbje dhe një amanet për brezat.

Pas çlirimit, vijoi karrierën në strukturat e Ushtrisë Popullore Shqiptare, duke mbajtur detyra të ndryshme drejtuese. Në vitin 1961 u gradua nënkolonel, ndërsa paralelisht ndoqi studimet për Histori dhe Letërsi në Universitetin e Tiranës. Kështu, përvoja ushtarake dhe pasioni për historinë e librin u bashkuan në një personalitet, i cili do ta kthente kujtesën në mision të jetës.

Nga ushtaraku te shkrimtari i kujtesës

Në vitet 1964–1969, Resul Bedo drejtoi sektorin e kulturës në Drejtorinë Politike të Ministrisë së Mbrojtjes. Më vonë, duke iu kushtuar gjithnjë e më shumë krijimtarisë, ai ndërtoi një veprimtari të gjerë letrare dhe dokumentuese, duke shkruar për luftën, dëshmorët, komandantët, shokët e armëve dhe njerëzit që historia nuk duhet t'i harrojë.

Me një krijimtari që përfshin mbi 120 libra, Bedo la pas një trashëgimi të pasur në letërsinë dhe kujtesën historike shqiptare. Ndër veprat e tij përmenden "Nga Kuçi në Vishegrad", "Shqiponjat e vogla", "100 episode partizane", "Ata mbetën përgjithmonë ushtarë", "Armë të pathyera", "Edhe ne luftuam", "Grusht çelik Brigad' e Gjashtë", "Çlirimi i Shkodrës", "Gjurmë të ndezura", "Pishtarë të lirisë", "Kështjella partizane e Cepos", "Fushëbardha, shtëpia e të gjithëve" dhe "Ditar i Divizionit të VI Sulmues të UNÇSH-së".

Megjithatë, vepra që e identifikon më fuqishëm emrin e tij mbetet seria **"Yje të pashuar"**, kushtuar dëshmorëve të Atdheut. Përmes saj, Resul Bedo nuk synoi vetëm të rrëfente ngjarje historike, por të ruante jetët, emrat dhe sakrificat e njerëzve që dhanë gjithçka për lirinë. Ai e kuptonte se kujtesa kombëtare nuk ndërtohet vetëm me përshkrimin e betejave të mëdha, por edhe duke ruajtur historinë e çdo njeriu që u bë pjesë e tyre. "Për dëshmorët e shkruara nuk ka fund, dhe unë e quaj veten ushtar të Shqipërisë", shprehte ai filozofinë e vet të përkushtimit. Ndërsa mendimi se "Yjet ndrisin më shumë kur janë pranë njëri-tjetrit" përmbledh më së miri idenë që përshkoi veprimtarinë e tij: sakrificat individuale marrin kuptim edhe më të madh kur bashkohen në kujtesën e një kombi.

"Yje të pashuar", monumenti i një jete

Resul Bedo u nda nga jeta, më 10 janar 2019, në Tiranë, në moshën 92-vjeçare, duke lënë pas një vepër të gjerë dhe një shembull të veçantë përkushtimi ndaj kujtesës historike. Ai ndërtoi memorialet e tij me libra. Aty ku lapidarët ngrihen me gurë e mermer, ai ngriti monumente me fjalë, dokumente, fotografi, rrëfime dhe jetë njerëzish.

Prandaj, figura e tij nuk mund të kufizohet vetëm te ajo e një ish-partizani apo ushtaraku madhor. Ai ishte edhe dëshmitar i një periudhe të rëndësishme të historisë shqiptare, autor që u përpoq ta kthente përvojën e jetuar në dëshmi të shkruar dhe ta mbronte kujtesën nga harresa.

Për kontributin e tij u nderua me medalje, urdhra dhe vlerësime të ndryshme, ndër të cilat "Medalja e Trimërisë", "Medalja e Kujtimit", "Medalja e Shërbimit Ushtarak", si dhe vlerësime nga organizatat e veteranëve, të dëshmorëve dhe Qarku i Gjirokastrës.

Në 100-vjetorin e lindjes së tij, vepra dhe përkushtimi i Resul Bedos meritojnë të kujtohen e të vlerësohen më gjerësisht nga institucionet e mbrojtjes, organizatat e veteranëve e të dëshmorëve, komuniteti i Fushëbardhës dhe institucionet vendore të Gjirokastrës e Tiranës. Një vlerësim i posaçëm institucional dhe përjetësimi i emrit të tij në hapësirën publike do të përbënin një shenjë mirënjohjeje për njeriun që ia kushtoi jetën dokumentimit të sakrificës së të tjerëve.

Resul Bedo u largua nga kjo botë, por la pas një mision që vazhdon. "Yje të pashuar" nuk është vetëm titulli i një serie librash, por simboli i një përpjekjeje të gjatë për të mos lejuar që emrat e dëshmorëve të treten në heshtjen e kohës.

Një shekull pas lindjes së tij, mesazhi i veprës së Resul Bedos mbetet aktual: një komb që nderon historinë e vet, ruan kujtesën e atyre që sakrifikuan dhe ua përcjell brezave të ardhshëm të vërtetën e së shkuarës, ndërton edhe më mirë vetëdijen për të ardhmen.

Sepse librat mund të zverdhen nga koha, por kujtesa që ata mbartin nuk duhet të shuhet kurrë. Dhe për sa kohë emrat e dëshmorëve do të ruhen, lexohen e përcillen te brezat, **yjet që Resul Bedo mblodhi në faqet e librave të tij do të vazhdojnë të ndriçojnë.**

Zërat që mbetën në zemër: 50 vjet këngë, miqësi dhe kujtime të paharruara

Grupi Polifonik i Shkollës së Lartë të Bashkuar të Oficerëve, një histori e veçantë artistike në 50-vjetorin e krijimit



VERI TALUSHLLARI, KAPITEN (R)

Gjysmë shekulli më parë, në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve, një grup studentësh ushtarakë e shndërruan dashurinë për këngën labe në një përvojë të veçantë artistike. Nga provat e para në klasat e shkollës te Koncertet e Majit, Ansambli i Ushtrisë dhe skenat e mëdha kombëtare, grupi la gjurmë në jetën kulturore të institucionit. Pesëdhjetë vjet më pas, kujtimet e njërit prej protagonistëve rikthejnë historinë e një brezi që bashkoi uniformën, artin dhe miqësinë.

Një këngë, disa zëra dhe një ide e madhe

Ishte si një aksiomë, kudo që të shihje **Vitri Bozhanin**, herët a vonë do të shpërthente kënga labe. E kishim njohur që në vitet e Shkollës "Skënderbej" dhe e pamë sërish gjatë stazhit në Fierzë, ku mblidhte disa bashkë-krahinorë dhe kënga gjëmonte, pa pasur nevojë për skenë e spektatorë.

Në vjeshtën e vitit 1976, sapo kishim nisur studimet në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve "Enver Hoxha", Vitriu u shfaq në klasën tonë. Përshëndeti shokët e vjetër dhe iu drejtua me përzemërsi Bino Seferit e Agim Çaushit, dy studentëve që vinin nga jeta civile.

Nuk kaloi shumë dhe në katin e parë të Akademisë Ushtarake, ku ishin vendosur klasat e Grupit të Artilerisë Kundërajrore, u dëgjua kënga labe. Binoja dhe Agimi ishin njohur me Vitriun gjatë muajit të punimeve fortifikuese në Zall-Herr. Aty, mes transheve dhe pozicioneve të zjarrit, kishin zbuluar harmoninë e zërave të tyre.

Edhe në klasën tonë kishte djem që mund ta mbanin ison. Lefteri, Dilaveri, Veroja, Astriti, Xhezmiu dhe Idaiu u bënë pjesë e grupit, ku u bashkuam edhe unë e Dalip Hazizi nga Gramshi. Kënga mori formë, por Vitriu synonte më shumë se një bashkim shokësh për të kënduar në kohën e lirë. Ai donte të krijonte një grup polifonik të mirëfilltë, të denjë për skenën.

Plotësimi i grupit me një zë femëror ishte hapi i radhës. Zgjidhja erdhi me **Sheqere Memën,** studente e vitit të dytë, artiste nga Gramshi dhe pjesëmarrëse si valltare në Festivalin Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës. Me zërin e saj melodioz dhe aftësinë për të kapur menjëherë intonacionin e këngës labe, Sheqerja u bë një nga figurat kryesore të grupit.

Krahas saj, në iso u bashkuan Bukurie Skënderi, Natasha Mamo, Meme Novruzaj e vajza të tjera. Kështu lindi **Grupi Polifonik i Shkollës së Lartë të Bashkuar të Oficerëve**, një formacion që shumë shpejt do ta kapërcente hapësirën e shkollës.



Nga provat në klasë, te skenat kombëtare

Shfaqjet e para në sallën e kinemasë së Shkollave Ushtarake u pritën me duartrokitje të nxehta. Përpara kishim studentët ushtarakë dhe skënderbegasit, por suksesi i grupit nuk mbeti vetëm brenda auditorëve.

Mjeshtri **Kujtim Laro**, udhëheqësi artistik i Ansamblit të Ushtrisë, vlerësoi aftësitë e grupit dhe, disa muaj më vonë, e përfshiu në programin e Koncerteve të Majit 1977. Ky ishte momenti kur emri ynë nisi të njihej përtej mureve të shkollës.

Repertori përfshinte këngë trimërie, këngë për heronjtë e dëshmorët e Atdheut, për punën dhe mbrojtjen e vendit. Por veçantia jonë qëndronte edhe te larmia e motiveve. Vitri Bozhani dhe Sheqere Mema merrnin këngën, ndërsa Agim Çaushi dhe Bino Seferi e kthenin me mjeshtëri. Motivet e Bënçës, Himarës, Kuçit, Pilurit, Gjirokastrës, Tepelenës e Vlorës i jepnin repertorit ngjyra të ndryshme, duke ruajtur karakterin e këngës së çdo treve.

Grupi ndikoi edhe në gjallërimin e jetës artistike të shkollës. Lutfi Zyka dhe, veçanërisht, Arben Vejsiu, i palodhur në organizimin e dramave dhe koncerteve, dhanë një kontribut të çmuar në këtë drejtim. Me nismën dhe përkushtimin e tyre, shumë studentë iu bashkuan edhe korit të Ansamblit të Ushtrisë.

Në veprimtaritë për 35-vjetorin e Ushtrisë Nacionalçlirimtare,



këngët e para të korit, ndër to edhe "Himni i Ushtrisë NÇ", u drejtuan **nga Gaqo Avrazi,** krijuesi legjendar i Ansamblit të Ushtrisë. Ndërsa dirigjenti i ri **Alqi Lepuri** ndihmoi në përgatitjen artistike të studentëve, duke e ngritur më tej nivelin e interpretimit.



"Zoga Kaçake e Malit", kulmi i një përjetimi skenik

Koncertet e Majit 1978 na vunë përpara një sfide të veçantë.

Mjeshtri Kujtim Laro kishte përgatitur një valle trimërie mbi motivet e këngës "Zoga Kaçake e Malit", të lidhur me krijimtarinë e Lefter Çipës dhe Grupit të Pilurit. Vallja, e interpretuar nga Artisti i Merituar Norbert Krasniqi, Violeta Gjora dhe Grupi i Valleve, duhej të niste me vargjet e këngës. Për këtë, Kujtimi thirri grupin tonë.

"Zunë malet të rënkojnë,
Zunë kaçakët të shkojnë,
Nënë, do të shkoj dhe unë..."

Zëri i **Sheqere Memës** ngrihej mbi ison tonë, ndërsa muzika e Kujtim Laros shoqëronte hyrjen e valltarëve. Kënga, vallja dhe orkestra krijonin një skenë plot forcë e emocion. Që në tingujt e parë, publiku shpërthente në duartrokitje.

Për ne, ishte një nga ato çaste kur puna dhe pasioni merrnin shpërblimin më të bukur: reagimin e drejtpërdrejtë të publikut.

Në të njëjtat koncerte interpretuam edhe një këngë me tekst të **Arben Dukës.** Përzgjedhja jonë për koncertin me këngë e valle të zgjedhura, ku merrte pjesë edhe udhëheqja e lartë e shtetit, ishte një tjetër vlerësim për grupin.

Siç kam treguar edhe në kujtimet për Komandant Rustem Peçin, gjatë atij koncerti, mes duartrokitjeve të zgjatura, interpretuam edhe një këngë të dytë, me tekstin tim, duke kapërcyer rregullin që parashikonte vetëm një interpretim. Edhe kjo këngë u prit me sukses dhe grupi u nderua me një çmim.



Një grup që këndoi përtej mureve të shkollës

Viti 1978 na solli përvoja të tjera të paharruara. Si pjesë e turneut tradicional të Ansamblit të Ushtrisë, dhamë shfaqje në garnizonin e Korçës, në Bilisht, Bitinckë, Sheqeras dhe Qafën e Kazanit.

Po atë vit, morëm pjesë në koncertin e madh që përmbylli Kongresin e Grave në Durrës. Patëm kënaqësinë të këndonim përkrah artistëve të njohur Golik Jaupi, Paro Ziflaj dhe Hysni Zela, si dhe grupit të Ansamblit Shtetëror të Këngëve dhe Valleve Popullore.

Një tjetër përvojë ishte pjesëmarrja në koncertin e Vitit të Ri të Radio Televizionit Shqiptar. Më pas, na ftuan edhe në Kinostudion "Shqipëria e Re", ku interpretuam motivin muzikor për filmin "Guna mbi tela".

Ndërkohë, vazhdonim jetën intensive të studentëve ushtarakë. Fushimet dimërore e verore në Feken dhe Karpen, marshimet shumëditore në gjurmët e Shtabit të Përgjithshëm dhe të Brigadës së Parë të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, ishin pjesë e formimit tonë. Fotografia e realizuar në Galigat të Gramshit na kthen edhe sot te ato ditë, te shokët dhe përjetimet që na lidhën përtej studimeve e detyrimeve ushtarake.

Në vitin 1979 dhe më pas, grupi vazhdoi të merrte pjesë në veprimtaritë e Ansamblit të Ushtrisë dhe në aktivitetet e organizuara në SHQUP. Kur brezi ynë përfundoi studimet dhe u shpërnda në detyra të ndryshme, traditën e vijuan studentët më të rinj, mes tyre Albert Habazaj, Tomor Lelo, Subi Çako, Bajram Xhaka e të tjerë.

Kjo ishte prova se grupi nuk kishte qenë thjesht një bashkim i përkohshëm zërash. Ai kishte krijuar një traditë që mund të përcillej nga një brez te tjetri.

Pesëdhjetë vjet kujtime, një miqësi që vazhdon

Sot, pesëdhjetë vjet pas krijimit të grupit, kujtimet mbeten të gjalla. Kur takohemi, siç ndodhi disa vite më parë në Ardenicë, bisedat kthehen te provat e para, koncertet, udhëtimet dhe shokët me të cilët ndamë një përvojë të papërsëritshme.

Në këto kujtime, emrat e Vitri Bozhanit, Sheqere Memës, Bino Seferit, Agim Çaushit dhe të gjithë pjesëtarëve të tjerë mbeten të lidhur me një histori ku talenti, pasioni dhe miqësia u bënë një.

Jeta ushtarake na përgatiti për përgjegjësi të mëdha, për disiplinë dhe përkushtim ndaj detyrës. Por vitet na kanë mësuar se formimi i njeriut nuk ndodh vetëm në auditorë dhe në terrenet e stërvitjes. Ai pasurohet edhe nga arti, kultura dhe traditat që na lidhin me njëri-tjetrin.

Grupi ynë dëshmoi se dashuria për këngën popullore mund të bashkëjetojë natyrshëm me uniformën dhe profesionin ushtarak. Nëpërmjet saj, studentë me prejardhje e përvoja të ndryshme gjetën një gjuhë të përbashkët dhe krijuan një histori që kapërceu kufijtë e shkollës.

Pesëdhjetë vjet më pas, krenaria jonë nuk buron vetëm nga ajo që arritëm në skenë, por edhe nga tradita që lamë pas. Ishim pjesë e një ngjarjeje të vërtetë artistike në historikun e Shkollës së Lartë të Bashkuar të Oficerëve, me jehonë në jetën kulturore të Ushtrisë.

Dhe sa herë që rikthehemi te ato vite, në kujtesë dëgjojmë sërish këngën labe: zërin e marrësit dhe ison e shokëve. Një këngë që na bashkoi atëherë dhe që, edhe sot, vazhdon të na mbajë pranë.

Redaksia e Shtypit Ushtarak shpreh mirënjohjen dhe falënderimin e veçantë për **z. Veri Talushllari,** i cili, përtej oqeanit, vijon të ndajë me ne kujtime, përjetime dhe mbresa të çmuara nga jeta e tij ushtarake dhe nga rrugëtimi i brezave të Skënderbegasve.

Përmes penës së tij, këto dëshmi të vyera kapërcejnë largësitë dhe bëhen ura lidhëse mes brezave, duke ruajtur gjallë vlerat e miqësisë, të përkushtimit, të atdhedashurisë dhe të traditës ushtarake. Ato nuk janë thjesht rrëfime të së shkuarës, por përvoja jetësore që meritojnë të njihen, të ruhen dhe të merren si pikë referimi nga brezat e rinj.

E falënderojmë z. Talushllari për besimin, bashkëpunimin dhe kontributin e tij në pasurimin e faqeve të gazetës sonë me histori që mbartin emocion, dinjitet dhe vlera të qëndrueshme. Largësia gjeografike nuk e ka zbehur lidhjen e tij me shokët, kujtimet dhe vendin, përkundrazi, e ka kthyer këtë lidhje në një dëshmi të bukur të përkatësisë dhe të respektit për historinë e përbashkët.

Mirënjohje për çdo kujtim që na beson, për çdo përvojë që ndan dhe për çdo vlerë që përcjell te brezat që vijnë!

Llukan Ceka, një jetë e shkurtër, një përjetësi në kujtesën e atdheut

Historia e një kombi shkruhet edhe përmes sakrificave të atyre që nuk patën mundësi të jetonin gjatë, por që me guximin dhe vendosmërinë e tyre lanë gjurmë të pashlyeshme në kujtesën kombëtare. Një prej këtyre emrave është Llukan Sokrat Ceka, djaloshi nga Peshtani i Tepelenës, i cili më 18 tetor 1943, në kodrat e Picallit, pranë Tiranës, dha jetën në luftën kundër pushtuesve nazistë. Në moshën njëzetvjeçare, ai la pas ëndrrat e një rinie të sapolindur dhe u bë pjesë e historisë së atyre që zgjodhën të luftonin për lirinë e atdheut, duke e shndërruar jetën e tyre të shkurtër në një kujtim që i qëndron kohës.

Tetëdhjetë e tre vjet pas rënies së tij, kujtimi i Llukanit nuk i përket vetëm një familjeje, një fshati apo një krahine. Ai është pjesë e historisë së atyre brezave që, në një nga periudhat më të rënda të Shqipërisë, u përballën me pushtimin fashist dhe nazist, duke vënë në provë guximin, bindjet dhe dashurinë për vendin. Është kujtimi i një të riu që nuk pati mundësi të shihte Shqipërinë e lirë, të ndërtonte familjen e vet e të ndiqte ëndrrat që i përkasin moshës së tij. Megjithatë, emri i tij mbeti i lidhur përgjithmonë me një ideal që kapërcen jetën individuale: lirinë e atdheut.

Një djalë nga Peshtani, një histori e një brezi

Llukan Sokrat Ceka lindi, më 26 korrik 1923, në Peshtan të Tepelenës, në familjen e Sokratit dhe Argjiros. Ishte djali i vetëm mes shtatë motrash, në një familje shqiptare ku puna, ndershmëria, qëndresa dhe dashuria për vendin përbënin vlera të trashëguara brez pas brezi. Fëmijëria e tij u formua në atë mjedis të thjeshtë, ku njeriu mësonte herët kuptimin e sakrificës dhe të përgjegjësisë, ndërsa jeta kërkonte mund e përkushtim.

Por koha në të cilën u rrit Llukan Ceka nuk u dha të rinjve luksin e një rinie të qetë. Varfëria, vështirësitë ekonomike dhe padrejtësitë shoqërore i detyronin shumë prej tyre të përballeshin herët me barrën e jetës. Pa mbushur ende 15 vjeç, Llukanit iu desh të largohej nga fshati për të kërkuar punë. Fillimisht shkoi në Vlorë, më pas në Elbasan dhe, në fund, në Tiranë, ku punoi si kamarier dhe punëtor i thjeshtë.

Pas këtyre lëvizjeve qëndron historia e një adoleshenti që u detyrua të piqej përpara kohe. Në vend të librave, lojërave dhe ëndrrave të një fëmije, ai njohu lodhjen e punës dhe vështirësitë e mbijetesës. Përvoja e tij ishte ajo e shumë të rinjve shqiptarë të asaj kohe, të cilëve jeta u kërkoi të bëheshin të rritur shumë më shpejt nga sa duhej.

Megjithatë, vështirësitë nuk ia shuan ndjeshmërinë ndaj fatit të vendit. Përkundrazi, ato e ndihmuan të kuptonte më thellë padrejtësinë dhe nevojën për ndryshim. Llukan Ceka nuk e pa jetën vetëm si një përpjekje për të siguruar bukën e përditshme. Ai e kuptoi se mbi fatin e individit rëndonte edhe fati i një kombi të pushtuar, i një populli që kërkonte të jetonte i lirë në tokën e vet.

Kur ndërgjegjja bëhet më e fortë se frika

Pushtimi fashist i Shqipërisë nuk e gjeti Llukanin të shkëputur nga realiteti që e rrethonte. Në Tiranë, ai u lidh me të rinj antifashistë dhe u përfshi gjithnjë e më shumë në veprimtarinë kundër pushtuesve. Më 28 nëntor 1941, mori pjesë në demonstratën e organizuar në kryeqytet kundër pushtimit. Ky angazhim e bëri të njohur si kundërshtar të fashizmit dhe e ekspozoi ndaj rrezikut të arrestimit.

Shokët, të shqetësuar për sigurinë e tij, e këshilluan të largohej nga Tirana dhe të shkonte në Durrës. Por Llukanit nuk iu duk e drejtë që largimi nga rreziku të nënkuptonte shkëputjen nga lufta. Ai vazhdoi të mbante lidhje me bashkëpunëtorët e tij dhe të kontribuonte në organizimin e veprimtarisë antifashiste.

Ky qëndrim dëshmon për një vendosmëri që nuk buronte nga dëshira për t'u dalluar, por nga bindja se liria kërkonte angazhim. Në kohë të vështira, kur heshtja mund të dukej rruga më e sigurt dhe tërheqja një zgjedhje më e lehtë, Llukan Ceka vendosi të mos qëndronte mënjanë. Ai e kuptoi se pushtimi nuk ishte vetëm një çështje e ushtrive dhe e fronteve ushtarake; ishte edhe një çështje ndërgjegjeje, dinjiteti dhe përgjegjësie ndaj vendit.

Historia e tij na kujton se qëndresa antifashiste nuk u ndërtua vetëm në fushat e betejave. Ajo nisi edhe në rrugët e qyteteve, në takimet e fshehta, në lidhjet mes të rinjve dhe në vendimet e vështira të njerëzve që pranuan të rrezikonin jetën për një të ardhme tjetër. Çdo veprim, çdo qëndrim dhe çdo sakrificë ishte pjesë e një përpjekjeje më të madhe për ta çliruar Shqipërinë nga pushtimi.

Nëntë ditë që e ndanë nga përjetësia

Në korrik të vitit 1943, Llukan Ceka doli partizan dhe u rreshtua në batalionin Krujë–Ishëm. Në fillim të tetorit, së bashku me partizanë të tjerë, u drejtua për në Arbanë dhe, më 9 tetor 1943, u bë pjesë e Brigadës së Tretë Sulmuese. Ishte vetëm njëzet vjeç. Përpara tij shtrihej një rrugë e



vështirë, e mbushur me rreziqe, përballje dhe sakrifica. Ai kishte zgjedhur të ishte në radhët e atyre që luftonin për çlirimin e vendit.

Vetëm nëntë ditë pas përfshirjes në Brigadën e Tretë Sulmuese, jeta e tij do të merrte fund në fushën e betejës.

Më 18 tetor 1943, brigada u përfshi në aksionet luftarake në zonën e Tiranës. Në kodrat e Picallit, gjatë përleshjeve me forcat naziste gjermane, Llukan Sokrat Ceka ra dëshmor. Ai u bë dëshmori i parë i Brigadës së Tretë Sulmuese, duke lënë në historinë e saj një gjurmë që nuk mund të matet me kohëzgjatjen e jetës, por me peshën e sakrificës.

Njëzet vjet jetë. Vetëm njëzet vjet. Mjaftueshëm për të njohur vështirësitë, për të kuptuar padrejtësinë dhe për të zgjedhur një ideal, por shumë pak për të përjetuar gëzimet e një jete të plotë. Ai nuk pati mundësi të shihte fundin e luftës, të dëgjonte lajmin e çlirimit, të kthehej në Peshtan e të përqafonte prindërit dhe motrat. Nuk pati mundësi të ndërtonte familjen e vet, të krijonte kujtime të reja dhe të ndiqte rrugët që jeta mund t'i kishte hapur.

Por rënia e tij nuk mbeti vetëm dhimbje. Për bashkëluftëtarët, ajo ishte një plagë e thellë, por edhe një thirrje për të vazhduar luftën. Humbja e një të riu që sapo kishte hyrë në radhët e brigadës e bënte edhe më të prekshme koston njerëzore të lirisë. Në atë moshë, çdo jetë e humbur ishte një e ardhme e ndërprerë; çdo dëshmor ishte një kujtesë se çlirimi i vendit kërkonte sakrifica të rënda.

Dhimbja e Peshtanit dhe kujtesa që mbetet

Lajmi për vdekjen e Llukanit mbërriti në Peshtan dhe solli një dhimbje që nuk mund të përshkruhet lehtë me fjalë. Rinia e fshatit u mblodh në sheshin e Shën Mërisë. Për pesë minuta, gjithçka u mbulua nga heshtja. Më pas u qëlluan tri breshëri pushkësh në nderim të tij. Ishte një ceremoni e thjeshtë, por me një domethënie të jashtëzakonshme: një komunitet i tërë po i jepte lamtumirën njërit prej bijve të vet, një të riu që nuk do të kthehej më në shtëpi.

Më vonë, bashkëfshatarët dhe bashkëluftëtarët i kushtuan këngë e vargje, ndërsa në Picall u ngrit një lapidar në kujtim të djalit nga Peshtani, i cili mbeti përgjithmonë në ato kodra.

Këto gjeste, të lindura nga dhimbja dhe respekti, tregojnë se kujtesa për një dëshmor nuk mbahet gjallë vetëm nga dokumentet historike. Ajo jeton edhe në këngët që përcillen, në rrëfimet e brezave, në gurët përkujtimorë dhe në ndërgjegjen e një komuniteti që nuk pranon ta harrojë birin e vet.

Pas më shumë se tetë dekadash, emri i Llukan Sokrat Cekës meriton të kujtohet jo si një emër i largët në faqet e historisë, por si pjesë e një trashëgimie njerëzore që na përket të gjithëve. Ai ishte një djalë nga Peshtani, një punëtor i ri, një antifashist dhe një partizan. Përpara se të bëhej dëshmor, ishte njeri me ëndrra, me lidhje familjare, me shpresa dhe me një të ardhme që nuk arriti ta jetonte.

Të kujtosh një dëshmor do të thotë të shohësh përtej monumentit. Do të thotë të njohësh njeriun që qëndron pas emrit, jetën që u ndërpre dhe sakrificën që la gjurmë në historinë e vendit.

Detyrimi ynë ndaj atyre që nuk u kthyen

Tetori na rikthen te kjo histori, por kujtimi i Llukanit nuk duhet të kufizohet në një datë përkujtimore. Ai kërkon të jetë pjesë e edukimit historik, e kulturës sonë qytetare dhe e mënyrës se si brezat e rinj e kuptojnë të kaluarën. Një shoqëri që nderon dëshmorët e saj nuk e bën këtë vetëm me ceremoni, kurora dhe fjalime. Ajo e dëshmon respektin duke ruajtur dokumentet, duke përcjellë historitë e tyre, duke mirëmbajtur vendet përkujtimore dhe duke ua mësuar të rinjve kuptimin e sakrificave që qëndrojnë pas lirisë së sotme.

Për brezat e rinj, historia e Llukan Cekës mbart një mesazh të qartë: mosha nuk e përcakton madhështinë e një njeriu; atë e përcaktojnë zgjedhjet që bën, vlerat që mbron dhe përgjegjësia që merr përsipër. Në moshën kur shumë të rinj sapo nisin të ndërtojnë planet e tyre për jetën, ai zgjodhi të përballej me një realitet që rrezikonte të ardhmen e të gjithë vendit. Kjo nuk do të thotë se brezat e sotëm duhet të përjetojnë të njëjtat vuajtje apo të paguajnë të njëjtin çmim. Përkundrazi, nderimi më i madh për ata që ranë është të ndërtojmë një shoqëri ku liria mbrohet me përgjegjësi, ku dinjiteti njerëzor respektohet, ku drejtësia nuk mbetet vetëm një aspiratë dhe ku atdhedashuria shprehet përmes punës, ndershmërisë dhe përkushtimit ndaj së mirës së përbashkët.

Llukan Sokrat Ceka nuk pati mundësi ta shihte Shqipërinë e lirë. Kjo është dhimbja e historisë së tij, por edhe arsyeja pse kujtimi i tij duhet të mbetet i gjallë. Liria që gëzojmë sot nuk duhet parë si një realitet i shkëputur nga e kaluara, por si një përgjegjësi që kërkon të mbrohet dhe të përcillet nga një brez te tjetri.

Tetëdhjetë e tre vjet pas 18 tetorit 1943, kodrat e Picallit mbajnë kujtimin e njëzetvjeçarit që ra atje. Peshtani ruan emrin e birit të vet. Historia ruan gjurmën e partizanit që u bë dëshmori i parë i Brigadës së Tretë Sulmuese. Ndërgjegjja jonë kombëtare ka detyrimin ta ruajë këtë kujtim përtej datave dhe përtej ceremonive.

Sepse disa jetë, ndonëse të shkurtra, lënë pas një mesazh që nuk shuhet. Disa emra nuk i përkasin vetëm kohës në të cilën jetuan, por edhe brezave që vijnë. Llukan Sokrat Ceka është një prej tyre.

Ai ra njëzet vjeç, por nuk u shua nga kujtesa. Mbeti një yll i pashuar i historisë sonë, një dëshmi e çmimit të lirisë dhe një emër që meriton të shqiptohet gjithmonë me respekt, mirënjohje dhe nderim.

Lavdi dëshmorit të atdheut, Llukan Sokrat Ceka! Kujtimi i tij qoftë i përjetshëm!

UDHËTIM NË ORIKUN E LASHTË

Nga gjurmët e qytetërimit antik te zbulimet arkeologjike në Pashaliman



EDUARD DEMO





Në bregun e Gjirit të Vlorës, aty ku historia e lashtë takohet me rëndësinë strategjike të detit, qyteti antik i Orikut ruan ende dëshmi të çmuara të një qytetërimi që i përket mijëvjeçarëve të kaluar. I vendosur në zonën e Pashalimanit, pranë kodrës së Paleokastrës, Oriku përfaqëson një nga qendrat më interesante arkeologjike të bregdetit shqiptar, një dëshmi e zhvillimit urban, e veprimtarisë detare dhe e marrëdhënieve tregtare në hapësirën e Adriatikut dhe Jonit.

Të vizitosh Orikun nuk do të thotë thjesht të shohësh rrënoja të një qyteti të lashtë. Do të thotë të lexosh historinë përmes gurëve, gjurmëve të ndërtimeve dhe kujtesës së një porti që, për shekuj me radhë, pati rëndësi të veçantë për lundrimin dhe komunikimin ndërmjet brigjeve.

Një qytet me rrënjë në antikitet

Sipas të dhënave arkeologjike, themelimi i Orikut lidhet me shekullin VI para Krishtit. Në traditat historike përmendet lidhja e tij me kolonistët e ardhur nga Eubea, ndërsa pozita gjeografike dhe marrëdhëniet me popullsitë vendase e vendosën qytetin në një hapësirë me rëndësi të veçantë historike.

I ngritur në një pikë të favorshme pranë detit, Oriku përfitoi nga kushtet natyrore të zonës dhe nga mundësitë që ofronte një liman i mbrojtur. Pozita e tij e bëri një pikë të rëndësishme për lundrimin, tregtinë dhe lëvizjet përgjatë bregdetit. Historia e tij është e lidhur ngushtë me zhvillimet politike dhe ekonomike të Epirit dhe të hapësirës ilire.

Emri i Orikut shfaqet në burime të autorëve të lashtë, të cilët e përmendin si një liman të rëndësishëm. Referenca ndaj qytetit gjenden në traditën gjeografike dhe historike antike, ndërsa më vonë ai përmendet edhe në veprat e autorëve që përshkruajnë ngjarjet politike e ushtarake të rajonit. Këto dëshmi e bëjnë Orikun pjesë të rëndësishme të hartës historike të brigjeve të Adriatikut dhe Jonit.

Një prej dëshmive të traditës së lashtë, e përcjellë nga leksikografi bizantin Stefan i Bizantit në veprën *De Urbibus et Populis* (“Mbi qytetet dhe popujt”), e përshkruan Orikun si një qytet pranë hyrjes së Adriatikut. Ky pozicion nuk ishte vetëm një avantazh ekonomik, por edhe një faktor që i jepte qytetit peshë strategjike në periudha të ndryshme historike.

Objektet më të hershme të gjetura në Orik, ndër të cilat amfora transporti të shekullit VI para Krishtit, përbëjnë dëshmi të rëndësishme të veprimtarisë dhe të lidhjeve tregtare të qytetit. Studimet e arkeologëve, përfshirë punën e Vasil Beretit, si dhe kontributet kërkimore të studiuesve të tjerë, kanë ndihmuar në njohjen më të mirë të kësaj qendre antike.

Kur historia doli në dritë gjatë punimeve ushtarake

Një kapitull me interes të veçantë në historinë e zbulimit të Orikut lidhet me mesin e viteve 1950. Gjatë punimeve për ndërtimin e objekteve ushtarake në bazën e Pashalimanit, efektivat dhe punonjësit që merreshin me ndërtimet ndeshën gjurmë e objekte që dëshmonin praninë e një qyteti të lashtë.

Sipas rrëfimeve mbi këtë periudhë, punimet u ndërprenë dhe autoritetet u njoftuan për zbulimet. Ky reagim i hapi rrugë interesimit dhe kërkimeve arkeologjike, duke e kthyer një ndërhyrje të zakonshme ndërtimore në pikënisje të një etape të rëndësishme të studimit shkencor të Orikut.

Në vitet 1958–1960 u zhvilluan kërkime arkeologjike në kuadër të bashkëpunimit shqiptaro-sovjetik, me pjesëmarrjen e studiuesve shqiptarë dhe të misionit arkeologjik sovjetik. Ndër emrat e lidhur me këtë fazë spikasin arkeologët shqiptarë Hasan Ceka dhe Dhimosten Budina, si dhe arkeologu rus Vladimir Dmitrievich Blavatsky. Në punën kërkimore në Orik morën pjesë gjithashtu arkeologia Tatiana V. Blavatskaya dhe studiues të tjerë të misionit.

Kontributi i Dhimosten Budinës ishte i rëndësishëm për zhvillimin e kërkimeve në këtë qendër antike. Pas studimeve dhe specializimit në Moskë, ku ndoqi leksionet e profesorit Blavatsky, ai u angazhua në nxitjen e bashkëpunimit arkeologjik dhe në organizimin e punës kërkimore në terren.

Gjatë këtyre gërmimeve u evidentua një strukturë monumentale gjysmërrethore në kodrën e Paleokastrës, e cila për një periudhë të gjatë u interpretua si teatër antik ose odeon. Ky identifikim u bë një nga elementet më të njohura të paraqitjes së Orikut në literaturën arkeologjike të kohës. Megjithatë, kërkimet e mëvonshme e rishikuan këtë interpretim, duke treguar se funksioni i strukturës kërkonte një vlerësim tjetër shkencor.

Kërkimet e reja, një dritare drejt qytetit të humbur

Pas një periudhe të gjatë, kërkimet arkeologjike në Orik morën një shtysë të re në vitin 2008, përmes bashkëpunimit shqiptaro-zviceran me pjesëmarrjen e studiuesve të Universitetit të Gjenevës. Më pas, kërkimet nënujore të zhvilluara nga ekipe të specializuara, përfshirë Fondacionin Octopus, ndihmuan në evidentimin e gjurmëve të portit dhe të pjesëve të qytetit të lashtë që sot ndodhen nën ujë.



Këto hulumtime zgjeruan njohuritë për shtrirjen dhe organizimin e Orikut, duke dëshmuar se një pjesë e rëndësishme e historisë së tij duhet kërkuar jo vetëm në sipërfaqen e tokës, por edhe në hapësirën nënujore të gjirit. Rishikimi i zbulimeve të mëparshme është pjesë e natyrshme e arkeologjisë moderne: çdo brez studiuesish, përmes metodave të reja, mund të plotësojë ose të korrigjojë interpretimet e mëparshme.

Në shkrimet e tij mbi Vlorën dhe rrethinat, Eqrem bej Vlora e përfshinte Orikun, të njohur edhe me emrin Pasha Liman në periudhën osmane, në panoramën e qendrave të rëndësishme historike të rajonit, krahas Apolonisë, Bylisit dhe Amantias. Vëzhgimet e tij mbi zhvillimin e kësaj hapësire dhe mbi rëndësinë e veprimtarisë bujqësore e ekonomike përbëjnë një pjesë të traditës së shkrimeve historike që kanë nxitur interesin për të kaluarën e Gjirit të Vlorës.

Trashëgimi që duhet ruajtur dhe përcjellë

Sot, qyteti antik i Orikut është pjesë e Parkut Arkeologjik të Orikut dhe përbën një pasuri të rëndësishme të trashëgimisë kulturore shqiptare. Vlera e tij nuk qëndron vetëm te lashtësia, por edhe te mundësia që u jep brezave të sotëm të kuptojnë marrëdhëniet ndërmjet qytetërimit, detit, tregtisë dhe strategjisë.

Për gazetën “Ushtria”, historia e Orikut ka edhe një domethënie të veçantë. Në këtë hapësirë, ku sot ndodhet baza ushtarake e Pashalimanit, trashëgimia e lashtë dhe prania moderne ushtarako-detare bashkëjetojnë në të njëjtin peizazh. Fakti që gjurmët e qytetit antik dolën në pah gjatë punimeve ushtarake tregon se ruajtja e sigurisë dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore mund të takohen në një përgjegjësi të përbashkët: njohjen dhe ruajtjen e pasurisë historike të vendit.

Kontributet e arkeologëve shqiptarë dhe të huaj, kërkimet e kryera ndër vite dhe studimet e autorëve që kanë shkruar për këtë qytet kanë ndihmuar që Oriku të mos mbetet një emër i largët në faqet e historisë, por një dëshmi e prekshme e së kaluarës sonë.

Në vitin 2002, në bashkëpunim me historianin dhe ish-drejtorin e muzeve të Vlorës, Novruz Barjamaj, dhe Ilia Çanon, u botua edhe një punim kushtuar Orikut, si kontribut modest për njohjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore.

Udhëtimi në Orikun e lashtë është, në fund të fundit, një udhëtim drejt rrënjëve të historisë, drejt kujtesës së një qyteti që për shekuj u lidh me detin dhe me zhvillimet e rajonit. Çdo gur, çdo fragment amfore dhe çdo gjurmë e portit përbën një pjesë të mozaikut historik që kërkon të studiohet, të mbrohet dhe t’u përcillet brezave të ardhshëm.

Oriku nuk është vetëm një qytet i së kaluarës. Ai është një dëshmi e gjallë se historia e Shqipërisë shkruhet edhe në brigjet e saj, aty ku deti ka qenë përherë udhë komunikimi, zhvillimi dhe rëndësie strategjike.



Kur Inteligjenca Artificiale bëhet rrezik ekzistencial

"P(doom)" është një term i thjeshtë në formë, por me peshë të jashtëzakonshme në përmbajtje: probabiliteti që Inteligjenca Artificiale e avancuar të shkaktojë fundin e civilizimit njerëzor. Ky koncept lidhet ngushtë me zhvillimin e AI-së të përgjithshme (AGI) – sisteme që mund të kryejnë çdo detyrë intelektuale më mirë se njerëzit. Në praktikë, kjo do të thotë një AI që mund të zëvendësojë çdo profesion, të marrë vendime strategjike dhe të kontrollojë sisteme kritike.

Shembull: Një AGI e aftë të menaxhojë zinxhirët globalë të furnizimit mund të sjellë efikasitet të paparë, duke ulur kostot dhe duke eliminuar vonesat. Por nëse objektivat e saj devijojnë nga interesat njerëzore – për shembull, duke optimizuar vetëm për efikasitet ekonomik pa marrë parasysh pasojat sociale – mund të shkaktojë kolaps ekonomik dhe destabilizim politik.

Pse ka rëndësi?

Edhe një probabilitet i vogël i katastrofës është i papranueshëm. Filozofi Nick Bostrom ka argumentuar se rreziku ekzistencial është më i rëndësishëm se çdo problem tjetër, sepse pasojat janë të pakthyeshme. Nëse një teknologji ka potencialin të sjellë prosperitet të pakufizuar, por edhe shkatërrim total, atëherë shoqëria duhet të veprojë me kujdes ekstrem.

Shembull: në energjinë bërthamore, edhe pse probabiliteti i aksidenteve është i vogël, investohen miliarda për siguri. Me AI-në, rreziku është më abstrakt, por pasojat mund të jenë edhe më të mëdha – nga manipulimi i informacionit deri tek kontrolli i infrastrukturës kritike. Një algoritëm i fuqishëm mund të manipulojë tregjet financiare, të destabilizojë zgjedhjet demokratike ose të marrë kontrollin e sistemeve ushtarake pa ndërhyrje njerëzore.

Debati akademik

Ekonomistët Jakub Growiec dhe Klaus Prettner kanë modeluar skenarët e mundshëm të zhvillimit të AGI. Ata tregojnë se në rastin e kontrollit të suksesshëm, AGI mund të sjellë një shpërthim të rritjes ekonomike, duke e çuar shoqërinë drejt një epoke *post-scarcity*. Por në rastin e dështimit, pasojat janë katastrofike: shkatërrim total i civilizimit.

Ky kontrast i skajshëm e bën të vështirë marrjen e vendimeve racionale. Një kompani që zhvillon AGI mund të ketë nxitje të forta ekonomike për të ecur përpara, edhe nëse probabiliteti i "doom" është 5%. Por nga perspektiva e shoqërisë, ky është një rrezik i papranueshëm. Kjo dilemë është e ngjashme me garën e armatimeve bërthamore gjatë Luftës së Ftohtë: shtetet nuk mund të ndalonin zhvillimin, por rreziku i shkatërrimit ishte gjithmonë i pranishëm.

Krahasimi i skenarëve

Cornucopia (*post-scarcity*): Një botë ku AI-ja automatizon çdo punë, prodhimi rritet në mënyrë të pakufizuar dhe pasuria shpërndahet gjerësisht. Shembull: robotë mjekësorë që kryejnë operacione pa gabime, sisteme bujqësore që prodhojnë ushqim pa kufi, inteligjencë artificiale që zgjidh krizën klimatike duke optimizuar energjinë e rinovueshme.

AI Doom: Një skenar ku AI-ja e pakontrolluar merr pushtetin, duke e parë njerëzimin si pengesë. Shembull: një sistem ushtarak autonom që vendos të neutralizojë kërcënimet pa dalluar civilët, ose një algoritëm ekonomik që shkatërron tregjet globale për të maksimizuar një objektiv të ngushtë.

Status quo: Një zhvillim i ngadalshëm, pa arritur AGI të plotë. Përmirësime graduale, rrezik i ulët, por edhe mungesë e transformimit të madh. Shembull: përdorimi i AI-së për rekomandime filmash, optimizim logjistik, diagnostikim mjekësor të kufizuar – përmirësime të dobishme, por jo revolucionare.

Rreziqet dhe masat

Rreziku kryesor është se një AI e avancuar mund të zhvillojë objektiva që nuk përputhen me interesat njerëzore. Shembull klasik është "paperclip maximizer": një AI e programuar të prodhojë kapëse letre mund të shkatërrojë gjithçka për të arritur qëllimin e saj.

Masat e propozuara për të shmangur këtë përfshijnë:

- Rritje e fondeve për kërkime në sigurinë e AI-së, për të zhvilluar metoda të kontrollit dhe përshtatjes.
- Korniza ndërkombëtare ligjore, që të mos lejohet një garë e pakontrolluar mes shteteve.
- Transparencë dhe auditim i algoritmeve, për të siguruar që sistemet e fuqishme të mos veprojnë në fshehtësi.
- Ndërprerje e zhvillimit të AGI nëse rreziku konsiderohet i papranueshëm, derisa të kemi garanci të forta për sigurinë.

Shembull praktik: Bashkimi Europian ka miratuar *AI Act*, një ligj që synon të vendosë standarde sigurie për përdorimin e AI-së. Megjithatë, ky ligj fokusohet më shumë tek aplikimet aktuale (si biometria, algoritmet e kredive) sesa tek rreziku ekzistencial i AGI-së. Kjo tregon boshllëkun midis politikës dhe realitetit teknologjik.

Diskutimi mbi "P(doom)" është një thirrje për reflektim global. Nuk është thjesht një debat filozofik, por një çështje praktike e mbijetesës së njerëzimit. Nëse probabiliteti i katastrofës është edhe i vogël, shoqëria duhet të veprojë me urgjencë.

Pyetja e madhe mbetet: a duhet të ndalet zhvillimi i AGI-së derisa të kemi garanci të forta për sigurinë, apo rreziku i frenimit të inovacionit është më i madh se rreziku i "doom"?

Nëse historia na ka mësuar diçka, është se teknologjitë e fuqishme gjithmonë sjellin përfitime dhe rreziqe. Energjia bërthamore, interneti, bioteknologjia – të gjitha kanë transformuar botën, por edhe kanë hapur dilema të reja. Me AI-në, dilema është ekzistenciale: a do të jemi ne që e kontrollojmë atë, apo ajo që do të kontrollojë ne?

Kompani si Google, OpenAI dhe Anthropic po garojnë për zhvillimin e AGI-së, shpesh duke vënë shpejtësinë mbi sigurinë, ndërsa qeveritë si SHBA, BE dhe Kina po përpiqen të vendosin rregulla për të frenuar rrezikun ekzistencial të "P(doom)". Ekspertët paralajmërojnë se balanca mes inovacionit dhe sigurisë është ende e paqëndrueshme.

Kompanitë e mëdha të teknologjisë

Google DeepMind: Ka investuar miliarda në kërkime për AGI, duke publikuar modele si *Gemini*. Megjithatë, kritikohet se fokusohet më shumë tek performanca sesa tek siguria.

OpenAI: Fillimisht u prezantua si organizatë e hapur për sigurinë e AI-së, por sot operon si kompani komerciale me investime të mëdha nga Microsoft. Ka publikuar modele si GPT-4 dhe GPT-5, duke paralajmëruar vetë për rrezikun e "doom".

Anthropic: U themelua nga ish-anëtarë të *OpenAI*, me fokus të veçantë tek "constitutional AI" – pra modele të ndërtuara mbi parime etike të qarta.

Meta dhe *Amazon*: Po investojnë në AI për aplikime praktike (rekomandime, cloud), por gjithashtu kontribuojnë në garën e shpejtë për modele më të fuqishme.

Shembull konkret: Kostoja për të trajnuar një model të avancuar arrin mbi 388 milionë dollarë, ndërsa raporti mes shpenzimeve për kapacitet dhe siguri është rreth 200:1 deri 1,200:1 – pra investohet shumë më tepër për fuqinë e modeleve sesa për sigurinë e tyre.

Qeveritë dhe rregullimi

SHBA: Ka nisur nisma për të vendosur standarde sigurie dhe transparence, por ende nuk ka një ligj gjithëpërfshirës për AGI-në.

Bashkimi Europian: Ka miratuar *AI Act*, i cili kategorizon aplikimet e AI-së sipas rrezikut. Megjithatë, ky ligj fokusohet më shumë tek përdorimet aktuale (biometria, kredia) sesa tek rreziku ekzistencial i AGI-së.

Kina: Po investon masivisht në AI, duke e parë si teknologji strategjike për dominim global. Rregullat e saj janë më shumë për kontroll politik sesa për siguri teknike.

Shembull praktik: Në raportet e fundit, ekspertët vlerësojnë se probabiliteti mesatar i "P(doom)" sipas sondazheve është rreth 10%, por disa e vendosin edhe mbi 50%.

Rreziku i garës për AGI

Studimet tregojnë se sa më shumë kompani të garojnë, aq më i madh bëhet rreziku. Çdo firmë ka nxitje të ecë më shpejt për të fituar avantazh, duke sakrifikuar sigurinë. Nëse një kompani ndalet, kjo nuk e mbron nga rreziku që krijojnë konkurrentët.

Balanca mes inovacionit dhe sigurisë është ende e paqëndrueshme. Kompanitë e mëdha po shtyjnë kufijtë e teknologjisë, ndërsa qeveritë përpiqen të vendosin rregulla, por shpesh mbeten pas ritmit të zhvillimit. Nëse historia e energjisë bërthamore na ka mësuar diçka, është se rregullimi global është i domosdoshëm për të shmangur katastrofën. Pyetja mbetet: a do të arrijë shoqëria të vendosë frena të forta përpara se AGI të bëhet realitet?



Revolucioni Teknologjik në Mbrojtje: Europa në Epokën e Sigurisë së Re

Europa po përballet me një realitet të ri gjeopolitik. Rritja e tensioneve ndërkombëtare, kërcënimet hibride dhe sfidat e sigurisë kibernetike po e shtyjnë kontinentin drejt një revolucioni të vërtetë në fushën e mbrojtjes. Ky transformim nuk është vetëm një përgjigje ndaj rreziqeve, por edhe një motor i fuqishëm inovacioni, që po krijon mundësi të reja për bizneset dhe po riformëson rajone të tëra.

Nga armët tradicionale tek inteligjenca artificiale

Për dekada me radhë, fuqia ushtarake europiane u mat me numrin e tankeve, avionëve luftarakë dhe sistemeve të raketave. Këto ishin mjetet kryesore të mbrojtjes, simboli i forcës dhe garancia e sigurisë së shteteve. Por sot, ky realitet ka ndryshuar rrënjësisht. Teknologjia e lartë ka hyrë fuqishëm në fushën e mbrojtjes, duke e transformuar atë në një epokë të re ku inteligjenca artificiale dhe sistemet digjitale po marrin rolin kryesor.

Inteligjenca artificiale si "truri" i mbrojtjes moderne

IA-ja po përdoret për analizën e të dhënave në kohë reale, për parashikimin e lëvizjeve të armikut dhe për automatizimin e vendimmarrjes. Ajo është bërë një mjet i pazëvendësueshëm në fushën e betejës, duke i dhënë komandantëve aftësinë të marrin vendime më të shpejta dhe më të sakta. Inteligjenca artificiale nuk është më thjesht një teknologji mbështetëse, por një element strategjik që po ndryshon mënyrën se si konceptohet lufta.

Dronët autonomë dhe hapësira e re e betejës

Dronët nuk janë më vetëm mjete survejimi. Ata janë shndërruar në platforma të afta për operacione sulmuese dhe mbrojtëse, duke reduktuar rrezikun për jetën e ushtarëve. Autonomia e tyre, e mbështetur nga inteligjenca artificiale, i lejon të veprojnë në terrene të vështira dhe të marrin vendime pa ndërhyrjen e njeriut. Kjo ka hapur një kapitull të ri në strategjitë ushtarake, ku teknologjia po zëvendëson fuqinë njerëzore.

Satelitët dhe kontrolli i hapësirës

Satelitët e avancuar janë bërë pjesë e pandashme e sigurisë europiane. Ata sigurojnë komunikim të pandërprerë, monitorim të territorit dhe mbrojtje kundër sulmeve nga hapësira. Kontrolli i orbitës është tashmë një element kyç i mbrojtjes, pasi çdo ndërprerje e sistemit satelitor mund të paralizojë operacionet ushtarake dhe infrastrukturën civile.

Lufta kibernetike si front i ri

Në epokën digjitale, sulmet kibernetike mund të kenë pasoja po aq shkatërruese sa një bombardim fizik. Paralizimi i rrjeteve energjetike, i sistemeve bankare apo i komunikimeve shtetërore është një rrezik real. Për këtë arsye, mbrojtja kibernetike është bërë prioritet absolut, duke u konsideruar si një "armë" e re e luftës moderne. Europa po investon në sisteme të sofistikuara për të mbrojtur rrjetet e saj dhe për të parandaluar sulmet që mund të destabilizojnë shtetet.

Një epokë e re e fuqisë ushtarake

Nga tanket dhe avionët e dikurshëm, mbrojtja europiane ka kaluar në një fazë ku fuqia matet me kapacitetin për të kontrolluar informacionin dhe për të përdorur teknologji të avancuara. Lufta nuk zhvillohet më vetëm në tokë, det apo ajër, por edhe në hapësirën digjitale dhe orbitale. Ky transformim po e fut Europën në një epokë të re, ku inteligjenca artificiale dhe teknologjia e lartë janë armët kryesore të sigurisë.

Një treg i ri për bizneset europiane

Ky revolucion teknologjik ka hapur dyer të reja për kompanitë e teknologjisë dhe industrinë e mbrojtjes. Startup-et që zhvillojnë algoritme për analizën e të dhënave, kompanitë që prodhojnë dronë inteligjentë apo platformat e sigurisë kibernetike po gjejnë terren pjellor për të rritur ndikimin e tyre. Bashkëpunimet mes sektorit privat dhe institucioneve shtetërore po bëhen gjithnjë e më të ngushta, duke krijuar një ekosistem inovacioni që shtrihet nga laboratorët e kërkimit deri tek fushat e betejës.

Rajonet në transformim

Investimet në teknologjitë e mbrojtjes nuk po ndryshojnë vetëm mënyrën se si shtetet mbrohen, por po riformësojnë edhe ekonomitë lokale. Ajo që dikur ishte një industri e rëndë, e mbështetur tek prodhimi klasik i armëve dhe pajisjeve ushtarake, po shndërrohet sot në qendra të teknologjisë së lartë. Ky proces po e kthen mbrojtjen në një katalizator të zhvillimit ekonomik dhe social.

Nga industria e rëndë tek teknologjia e avancuar

Shumë rajone europiane, të cilat dikur mbështeteshin tek fabrikat e çelikut, uzinat e tankeve apo prodhimi i avionëve tradicionalë, po kalojnë në një fazë të re. Ato po investojnë në laboratorë kërkimorë, qendra inovacioni dhe parqe teknologjike. Ky transformim po sjell një ndryshim të thellë në strukturën ekonomike, duke e zhvendosur fokusin nga prodhimi masiv drejt zhvillimit të teknologjive të sofistikuara.

Universitetet si motorë të zhvillimit

Universitetet dhe qendrat e kërkimit po marrin fonde të reja, duke u kthyer në aktorë kryesorë të këtij revolucioni. Ato po tërheqin talente nga e gjithë bota, duke krijuar një gjeneratë të re shkencëtarësh dhe inxhinierësh të specializuar në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Ky bashkëpunim mes akademisë dhe industrisë po gjeneron ide të reja, projekte inovative dhe produkte që më pas gjejnë përdorim jo vetëm në fushën ushtarake, por edhe në sektorin civil.

Punësimi dhe dinamika sociale

Transformimi teknologjik po krijon vende pune të reja, të cilat kërkojnë aftësi të specializuara. Nga programuesit e inteligjencës artificiale tek ekspertët e sigurisë kibernetike, tregu i punës po ndryshon rrënjësisht. Rajonet që dikur përballeshin me papunësi për shkak të rënies së industrisë së rëndë, sot po shndërrohen në qendra tërheqëse për profesionistë të rinj. Ky proces po sjell jo vetëm zhvillim ekonomik, por edhe një ndryshim kulturor, duke e bërë teknologjinë pjesë të identitetit lokal.

Riformësimi i hartës ekonomike të Europës

Ky revolucion po e riformëson hartën ekonomike të kontinentit. Rajone të cilat dikur ishin periferike po marrin një rol të ri si qendra inovacioni dhe zhvillimi. Investimet në teknologjitë e mbrojtjes po i japin këtyre zonave një rëndësi strategjike, duke i bërë pjesë të zinxhirit global të sigurisë dhe ekonomisë. Europa po krijon një ekuilibër të ri mes mbrojtjes dhe zhvillimit, ku fuqia ushtarake shkon paralel me progresin ekonomik.

Sfida dhe dilema etike

Revolucioni teknologjik në mbrojtje nuk sjell vetëm përparime të jashtëzakonshme, por edhe pyetje të vështira që prekin thelbin e etikës dhe të drejtës ndërkombëtare. Europa gjendet përballë një dileme të madhe: si të përqafojë inovacionin pa rrezikuar parimet e saj themelore të lirisë dhe të sigurisë.

Inteligjenca artificiale dhe vendimmarrja

Një nga sfidat më të mëdha është përdorimi i inteligjencës artificiale në fushën e luftës. Kur algoritmet marrin vendime në kohë reale, lind pyetja se kush mban përgjegjësi për pasojat. A është e pranueshme që një sistem autonom të vendosë për jetën dhe vdekjen pa ndërhyrjen e njeriut? Ky debat nuk është thjesht teknik, por moral, dhe kërkon një kornizë të qartë ligjore për të shmangur abuzimet.

Dronët autonomë dhe kontrolli njerëzor

Dronët e pajisur me inteligjencë artificiale janë tashmë realitet. Ata mund të veprojnë pa komandë direkte, duke analizuar situatën dhe duke ndërmarrë veprime të menjëhershme. Por çfarë ndodh kur këto vendime nuk përputhen me normat ndërkombëtare të luftës? Europa duhet të vendosë kufij të qartë mbi përdorimin e tyre, duke siguruar që kontrolli njerëzor të mbetet gjithmonë i pranishëm.

Siguria kundrejt lirisë

Një tjetër dilemë është balanca mes sigurisë dhe lirisë. Teknologjitë e mbrojtjes, sidomos ato kibernetike, mund të përdoren për të monitoruar qytetarët dhe për të kufizuar privatësinë. Ndërsa shtetet kërkojnë të mbrohen nga sulmet digjitale, ekziston rreziku që masat e sigurisë të shndërrohen në mjete kontrolli. Europa, e ndërtuar mbi parimet e demokracisë dhe të drejtave të njeriut, duhet të gjejë ekuilibrin mes mbrojtjes dhe respektimit të lirive themelore.

Politika dhe bashkëpunimi ndërkombëtar

Këto sfida nuk mund të zgjidhen vetëm me teknologji. Ato kërkojnë politika të mençura, ligje të qarta dhe bashkëpunim ndërkombëtar. Europa duhet të udhëheqë në krijimin e standardeve globale për përdorimin e inteligjencës artificiale dhe sistemeve autonome në mbrojtje. Vetëm përmes dialogut dhe marrëveshjeve ndërkombëtare mund të shmangen konfliktet dhe abuzimet.

Një përgjegjësi historike

Në fund, dilemat etike të revolucionit teknologjik në mbrojtje janë një përgjegjësi historike për Europën. Kontinenti ka mundësinë të tregojë se siguria dhe liria mund të bashkëjetojnë, se inovacioni mund të ecë paralel me etikën. Ky është një test i madh për të ardhmen, ku vendimet e sotme do të përcaktojnë jo vetëm mënyrën se si luftohet, por edhe mënyrën se si jetojnë shoqëritë europiane.

E ardhmja e mbrojtjes europiane

Në këtë kontekst, mbrojtja nuk është më thjesht një barrë financiare, por një investim strategjik. Europa po hyn në një epokë ku teknologjia e lartë është arma kryesore, dhe ku inovacioni është mburoja më e fortë. Ky revolucion nuk është vetëm një përgjigje ndaj kërcënimeve, por edhe një mundësi për të ndërtuar një kontinent më të sigurt, më të bashkuar dhe më konkurrues në arenën globale.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

Tetori Rozë

NUK ËSHTË THJESHT

NJË FJONGO ROZË



NJË THIRRJE PËR TË GJITHË

Të mos heshtim.
Të mos vonohemi.
Të mos e lëmë gruan vetëm.
Sepse pas çdo numri është një grua.